

BUXHETI BASHKIA E SHKODRËS

"Shkodra, me njerëzit kreativ, historinë e kulturën, mikpritjen e burimet natyrore, një komunitet që jeton e zhvillohet, derë e hapur për integrim"

Janar 2017

Përmbajtja

I.	Të dhëna demografike për Bashkinë e Shkodrës	9
II.	Buxheti i Bashkisë për Vitet 2017-2019.....	12
III.	Të Ardhurat e Bashkisë për vitet 2017-2019	19
	II.1 Të ardhurat nga burimet e veta vendore	19
	II.2 Të ardhurat nga burimet qendrore	20
A.	Te ardhurat e veta vendore	23
	A.1 Të ardhurat nga burimet e veta vendore sipas llojit	23
	A.2 Të ardhurat nga burimet e veta vendore sipas Njësive Administrative	27
B.	Kapacitetet fiskale të taksapaguesve	28
	B.1 Taksapaguesit familjarë	29
	B.2 Taksapaguesit biznese dhe institucione	30
C.	Analiza e të ardhurave të veta vendore dhe ndikimet e tyre në të ardhurat e bashkisë	34
	C.1 të ardhurat nga taksat vendore	34
	C.2 të ardhurat nga Tarifat Vendore	45
	C.3 të ardhura nga burime të tjera	50
IV.	Transferta nga buxheti i shtetit.....	52
IV.1	Transferta e Pakushtëzuar nga buxheti i shtetit.	52
IV.2	Transferta specifike sipas funksioneve.....	56
IV.3	Transferta e kushtëzuar.....	60
IV.4	Burime të Tjera Financimi.....	60
V.	Parashikimi i shpenzimeve për vitin 2017.....	61
Aneks 1:	Baza ligjore	67

Detajimi i Programeve buxhetore

- P1.Planifikim Manaxhim Administrim
- P2.Planifikimi urban
- P3.Infrastruktura rrugore
- P4.Sherbimet Publike
- P5. Transporti publik dhe levizshmeria
- P6. Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmi
- P7. Bujqesia dhe zhvillimi rural
- P8. Mjedisi dhe mbrojtja e Pyjeve e kullotave
- P9. Arsimi parauniversitar dhe edukimi
- P10. Strehimi dhe Shërbimet sociale
- P11. Kultura dhe sherbimet rekracionale
- P12. Rinia dhe Sportet
- P13. Emergjencat civile

Lista e prioriteteve të investimeveve sipas programeve të zhvillimit për të cilat kërkohen financime

LISTA E TABELAVE

TABELA 1 NDARJA NË LAGJE DHE FSHATRA NË NJËSITË ADMINISTRATIVE TË BASHKISË SË SHKODRËS	10
TABELA 3 PLANIFIKIMI PËR VITIN 2017- 2019 SIPAS PROGRAMEVE BUXHETORE.....	15
TABELA 4 PLANIFIKIMI I BUXHETIT SIPAS KLASIFIKIMIT EKONOMIK	16
TABELA 5 PLANIFIKIMI I SHPENZIMEVE SIPAS FUNKSIONEVE PËR VITIN 2017	17
TABELA 6 TË ARDHURAT NGA BURIMET E VETA TË BASHKISË PËR VITIN 2017-2019.....	20
TABELA 7 TË ARDHURAT NGA BURIMET QENDRORE	20
TABELA 8 TRANSFERTA SPECIFIKE PÛRKATËSISHT SIPAS FUNKSIONEVE TË TRANSFERUARA	21
TABELA 9 TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR DHE SPECIFIKE VITET 2016 DHE 2017.	22
TABELA 10 TË ARDHURAT NGA BURIMET E VETA VENDORE	24
TABELA 11 PLANI E TË ARDHURAVE TË VETA TË BASHKISË SHKODËR.....	26
TABELA 12 NGARKESA FISKALE SIPAS NJËSIVE ADMINISTRATIVE	27
TABELA 13 KAPACITETI I TAKSAPAGUESVE SIPAS GRUPIMEVE.....	28
TABELA 14 KAPACITETI I FAMILJEVE TAKSAPAGUESE.....	30
TABELA 15 KAPACITETI I BIZNESEVE DHE INSTITUCIONEVE TAKSAPAGUESE	31
TABELA 16 KAPACITETI I BIZNESEVE TË VEGJEL SIPAS NATYRES	32
TABELA 17 KAPACITETI I BIZNESEVE TË MËDHA SIPAS NATYRËS SË TYRE	33
TABELA 18 TË ARDHURA NGA TATIMI I THJESHTUAR	35
TABELA 19 REALIZIMI I SHPENZIMEVE PER VITIN 2016 SIPAS PROGRAMEVE.....	61
TABELA 20 PLANI I SHPENZIMEVE PER VITIN 2017 SIPAS PROGRAMEVE	64
TABELA 21 REALIZIMI I SHPENZIMEVE PER VITIN 2018 SIPAS PROGRAMEVE.....	65
TABELA 22 REALIZIMI I SHPENZIMEVE PER VITIN 2019 SIPAS PROGRAMEVE	66

LISTA E FIGURAVE

FIGURE 1 HARTA TREGUESE BASHKIA SHKODËR.....	9
--	---

LISTA E GRAFIKËVE

GRAFIKU 1 SHKALLA E PAPUNËSISË SIPAS GRUPMOSHAVE 2015 – 2016.....	11
GRAFIKU 2. BUXHETI SIPAS BURIMEVE TË FINANCIMIT	14
GRAFIKU 3 PLANI BUXHETOR SIPAS PROGRAMEVE	15
GRAFIKU 4 SHPENZIMET SIPAS KLASIFIKIMIT EKONOMIK VITI 2017	16
GRAFIKU 5 PLANI I SHPENZIMEVE SIPAS FUNKSIONEVE PËR VITIN 2017	18
GRAFIKU 6 TË ARDHURAT E BUXHETIT 2017	19
GRAFIKU 7 TË ARDHURAT NGA BURIMET QENDRORE PËR VITIN 2017.....	20
GRAFIKU 8 SHPERNDARJA E TRANSFERTES SPECIFIKE SIPAS PROGRAMEVE 2017.....	21
GRAFIKU 9 TË ARDHURAT NGA BURIMET E VETA	24
GRAFIKU 10 NDIKIMI NË PLANIN E TË ARDHURAVE, I ÇDO TAKSE DHE TARIFE	25
GRAFIKU 11 PLANIFIKIMI I TË ARDHURAVE, SIPAS NJËSIVE ADMINISTRATIVE	27
GRAFIKU 12 TAKSAPAGUESIT.....	29
GRAFIKU 13 NUMRI I FAMILJEVE TAKSAPAGUESE	29
GRAFIKU 14 FAMILJE ME LEHTËSI FISKALE	30
GRAFIKU 15 NUMRI I BIZNESEVE.....	31
GRAFIKU 16 KAPACITETI I BIZNESEVE TË VEGJEL SIPAS NATYRES	33
GRAFIKU 17 PESHA SIPAS ZËRAVE E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT VENDORE	35
GRAFIKU 18 TË ARDHURAT NGA TAKSA E BANESAVE SIPAS VITIT TË NDËRTIMIT	37
GRAFIKU 19 TË ARDHURAT NGA NDËRTESAT E BIZNESEVE, SIPAS LLOJIT TË AKTIVITETIT	39
GRAFIKU 20 TË ARDHURAT NGA TAKSA E TOKËS BUJQËSORE, SIPAS KATEGORISË SË BONITETIT TË TOKËS	40
GRAFIKU 21 TË ARDHURAT NGA TAKSA E TRUALLIT, SIPAS KATEGORIZIMIT LIGJOR.....	42
GRAFIKU 22 TË ARDHURAT NGA TAKSA E TABELES, SIPAS NDARJES LIGJORE	45
GRAFIKU 23 PESHA SIPAS ZËRAVE E TË ARDHURAVE NGA TARIFAT VENDORE	47
GRAFIKU 24 PESHA SIPAS ZËRAVE E TË ARDHURAVE NGA BURIME TË TJERA	51

Të dashur bashkëqytetarët e mi,
Të nderuar këshilltarë të Bashkisë së Shkodrës,

Ne e dime që puna e Bashkisë Shkodër është shumë e rëndësishme për cilësinë e jetës së çdo qytetari. Prandaj dhe jemi përpjekur për të punuar shumë në çdo cep të Bashkisë, për të qenë afër çdo familje Shkodrane kudo ajo ndodhet, në begdet apo në alpe, në qytet apo në rrethina. Dashuria për shkodren ka qenë frymëzimi ynë, ligji dhe respektimi i tij ka qenë metoda e dhe për rmirësimin e punës sone të përditshme, ndershmëria na ka drejtuar dhe shpresojmë se kemi arritur të bëjmë dicka për të përmirësuar jetën tuaj.

As në nuk e kemi pasur të lehtë. Trashëguam territore pa infrastrukturë rrugore, shkolla jo funksionale, qendra shëndetësore të pa mirë mbajtura. Borxhe dhe mungesë shërbimesh pothuajse kudo në një shtet administrativ. Një sërë detyrimesh të tjera na u transferuan pas reformës territoriale me mungesë fondesh dhe nga ana tjetër me detyrime e sanksione ligjore për t'i kryer ato. Në rrethim nga qeverisja qendrore dhe pa asnjë ndihmë, në përsëri kemi mundur të përmirësojmë qytetin dhe jetën e tij.

Vetëm në përvojat taksive vendore, që sot janë më të ultat në të gjithë vendin, kemi mundur të përfundojmë rikonstrukcionin e mbi 16 000 m² rrugë në territorin e qytetit. Me fjalë të tjera mund të themi se kemi mundur të rikonstruktojmë dhe përmirësojmë 27 rrugë dhe 2 sheshe, duke përfutur direkt rreth 25 mijë banorë. Më konkretisht:

- | | |
|---|--|
| 1. Rruga "MBRAPA ZYRES SE PUNES" | 13. Rruga "AHMET EFENDI KALAJA" |
| 2. Rruga "NE KRAH të DREJTORISE SE BUJQESISE + SHKOLLA NATES" | 14. Rruga "DANEJ" |
| 3. Rruga "RAMADAN SOKOLI" | 15. Rruga "AT DONAT KURTI SEGMENTI II" |
| 4. Rruga "ARADES" TROTUARI HAXHI IDRIZ BOKSI | 16. Rruga "TEK SHKOLLA 3 DHJETORI" |
| 5. Rruga "DASHEJ" | 17. Rruga "DEGEZIM BANJA E VOGEL" |
| 6. Rruga "SHEFQET MUKA" | 18. Rruga "KOL KAMZI" |
| 7. Rruga "CENAJ" | 19. Rrugice "TEK MEHMET PASHE PLAKU" |
| 8. Rruga "QENDRESA E 1920" | 20. Rruga "GJON DESTANISHTAJ" |
| 9. Rruga "DESHMORET E 1912-1913" | 21. Rruga "KUKLEJ" |
| 10. Rruga "NAZMI KRYEZIU" | 22. Rruga "KARL GURAKUQI" |
| 11. Rruga SEGMENT "DR. ALI SPAHIJA" | 23. Rruga "DR. TODI" |
| 12. Ndertim XHEP KAZANI në HAPESIREN E TROTUAREVE; | 24. Rruga "KEL KODHELI" |
| | 25. Rruga "AT MARTIN GJOKA" |
| | 26. Rruga të "FUSHA LEKURES" |
| | 27. Rruga "RINIA" |

Përveç asfaltimit, punimet në këto rrugë janë shoqëruar dhe me investime në kanalizime të ujërave të bardha dhe të zeza, si dhe në përmirësimin total të trotuareve të këtyre rrugëve veçse konkretisht

- ndërtim i rreth 3300 m² kanalizime të ujërave të bardha,
- ndertim i rreth 3200 m² kanalizime të ujërave të zeza,
- Ndërtim i rreth 1600 m² rrjeti i ri i ujësjes së qytetit dhe
- Rreth 2800 m² trotuare për kembesoret.

Investimet dhe mirëmbajtja në sistemin e kanalizimeve të ujërave e kanë veçuar shtetin Shkodren si të vetmin qytet në Shqipëri që nuk u përmyt nga shirat e dimrit dhe vjeshtës.

Gjithashtu jemi duke punuar dhe përfundojmë së shpejti rikonstruksionin e 17 rrugë ve dhe rrugicave në Bashkinë e Shkodrës. Prej ketyre vetë m në qendren historike të qytetit, do të kete perfunduar rikonstruksioni i plote i 12 rrugicave qe do të marrin pamjen e tyre tradicionale dhe do të jene shtruar e zbkuruar njekohesiht me gure dekorativ. Ky projekt do të kishte perfunduar brenda vitit, por punimet e tija do të zgjasin dhe pak jave pasi në keto projekte, me kerkese të vete qytetareve, u shtua dhe ndërhyrja e plotë në rrjetin e kanalizimeve të ujrave të bardha dhe të zeza, si dhe në rrjetin e ujesjellesit të zonë s.

Po ashtu 5 investime të tjera të cilat janë në proces, do të permiresojne jetë n e banorë ve të rrugeve “Qazim Ilazani”, Degëzimi “Isuf Sokoli”, rruga “Draçin”, rruga “Gjomarkaj”, berdice, Segmenti “Fusha e cunit kyqezim lagja Garuci, Oblike Ana e Malit. Me për fundimin e kë tyre investimeve, Shkodrës së shpejti i shtohen mbi 9000 m2 rrugë të riasfaltuara, 3000 ml kanalizime të ujrave të bardha, 3200 ml kanalizime të ujrave të zeza dhe mbi 2000 ml sisteme kanalizimi ujesjelles.

Këtë vit nisëm të investojmë edhe në brendesi të lagjeve të qytetit të Shkodrës. në besojme se investimet me të vlefshme per të permiresuar cilesine e jetes se qytetareve jane pikerisht permiresimi i infrastruktures se blloqeve të banimit. Investimet në brendesi të lagjeve tona, atje ku qytetaret, femijet tane apo prinderit tane kalojne pjesën më të madhe të kohës ndikojnë drejtepersedrejti në permiresimin e perditshmerise sone. Rikualifikimi urban qe kemi nisur në 4 blloqe banimi në lagjet Xhabije, “Qemal Draçini”, “Tepe të fusha e druve”, dhe blloku i banimit rruga “Pogej”, konsiston në shtimin e hapsirave të gjelbera me rreth 5800 m2, mbi 16000 m2 asfaltime, mbi 3400 ml kanalizime të ujrave të bardha, rreth 1700 ml kanalizim i ujrave të zeza, 730 ml ujesjelles dhe ndricim të plote të të gjithë këtyre blloqeve në çdo cep të tyre. Perjashtoj bllokun Xhabije ku qeveria harxhoi më shumë për të mashtruar dhe sulmuar Shkodrën se per të investuar në të , të gjitha rruget, sheshet dhe blloqet e banimit brenda lagjeve, po ndërtohen me paratë e banorëve të Shkodrës.

Thone se vetëm ndriçimi i rrugëve e bën qytetin qytet dhe nxjerr në pah bukuritë e tija, që Shkodra jonë fatmirësisht i ka me bollek. Prandaj dhe në një vit kemi investuar më shume se 15 milionë lekë vetëm për ndriçimin e rrugëve dhe rrugicave të qytetit në përmjet ndërhyrjes në sisteme ndricuese. Falë ketij investimi qyteti i Shkodrës pothuaj ndricon në cdo cep të tij në të gjitha lagjet, nga rruga “Terzive” tek rruga e “Tepes”, nga rruga “Danja” tek ajo e lidhjes se Prizrenit, nga Blloku i pallateve “Çakej” tek rruga “Roza Lejn”, nga rruga “Hotnej” tek ajo e “Hafiz Ulqinaku”, si dhe shume të tjera.

Ne vitin e pare, me paratë e buxhetit lokal, për herë të parë kemi ndriçuar 8 rrugë dhe qendra të njesive administrative. Kështu në Rrenz të Gurit të Zi, Gjomarkaj të Berdices, në Xhaferraj të Anes se Malit, në Boks, Dragoc, Kullaj të Postribes, në Bardhaj Rrethina, qendër hidrovor dhe pedonale e shesh qendror në Velipojë , kemi arritur të ndriçojmë një pjesë të territoreve të njesive administrative dhe synojmë që vitin e ardhshëm të bëjmë edhe më shumë në këtë drejtim. Ne besojmë qe ky invetim rrit sigurinë dhe zgjat oraret e jetës së qytetit dhe qendrave të banuara rurale edhe në oret e vona të mbrëmjes.

Pastertia e qytetit dhe territorit nuk është vetem investimi më i mirë për rritjen e vizitorë ve dhe turistëve të qytetit, por mbi të gjitha është shembull i kulturës qytetare, që Shkodra e ka obligim ta dëshmoje. Prandaj kemi shpenzuar jo pak nga të ardhurat tona për një territor të pastër dhe nje qytet higjenik. ne vazhdojme praktiken e mire të depozitimit të të gjithë mbetjeve urbane të qytetit dhe njesive administrative në landfillin e Bushatit dhe jemi i vetmi komunitet në Shqipëri që kontribuojmë me para që mbetjet të mos perfundoje në lumenjtë tanë, në kodrinat e Shkodrës apo në territorin e saj.

Dua të falenderoj se pari qytetarët shkodrane dhe bizneset që në përmjet korrektesës dhe kontributit të tyre, Bashkia Shkoder sot të mund të përballojë pothuaj të gjitha kostot e pastrimit të territorit.

Grumbullimi i mbetjeve në 8 njesi administrative ka filluar të behet për herë të parë me konteniere mbetjesh. Për një Shkodër sa më të pastër sivjet kemi blerë e shpërndarë mbi 700 konteniere të rinj dhe do vazhdojmë këtë praktikë edhe më tej.

Për një zhvillim urban sa më modern dhe të permbajtur njekohësisht, në jemi duke përmbyllur planin e ri urbanistik të qytetit të Shkodrës. Qëllimi ynë është të vazhdojmë të mbrojmë shkodrën nga betonizimi, të shtojmë hapsirat e gjelbërta, dhe të ndërtojmë qendra turistike sa më miqsore nga aspekti urban. Modeli urban i ndjekur në qytetet kryesore të vendit keto vitet e fundit, ka qenë ai i betonizimit për shkak të interesave korruptive që gjenerohen nga ky biznes.

Shkodra ka qenë i vetmi qytet që i ka shpetuar zhvillimit ekstrem kaotik urban, dhe në jemi koshient për përgjegjshmërinë e punës së bashkisë në këtë drejtim, prandaj dhe sigurojmë se plani i ri urbanistik do të jetë një kushtetutë urbane që do të garantojë një kohësisht dhe mbrojtjen edhe zhvillimin e territorit, do të përmirësojë hapsirat e gjelbërta dhe do të shtojë hapsirat rekreative kudo në territorin e Bashkisë Shkoder.

Arsimimi sa me i mire dhe në kushte sa me dinjitoze për femijet dhe të rinjte shkodrane ndoshta është misioni me i rendesishem i pushtetit vendor. Për këtë arsye në kemi prioritet përmirësimin e infrastruktures së arsimit parauniversitar kudo në territor, me qëllim që cdo i ri dhe femij shkodran, kudo ai të ndodhet, të zhvillojë procesin mesimor në kushte normale dhe dinjitoze.

Me perkujdesje kemi arritur të sigurojmë ngrohje në të gjitha kopshtet, shkollat nentevjecare dhe gjimnazet publike nën përgjegjësinë e Bashkisë Shkoder Po ashtu kemi shërbyer me materiale dhe mjetet e nevojshme infrastrukturë në arsimit parauniversitar.

Kemi arritur që në 1 vit të ndërhyjmë në përmjet mirë mbajtjes dhe meremetimeve në 28 objekte arsimore, kemi rikonstruktuar 3 objekte të tjera shkollore në qytet dhe jemi në përfundim të procesit të rikonstruksionit të infrastruktures së 2 shkollave të tjera në qytet dhe në Grudë të re në Rrethina. Përveç një kopshti të ri, kemi ndërhyrë me fonde të plota për rindërtimin e 2 shkollave të tjera krejtësisht të rrënuara. Dhe sot nxënësit e shkollave të Prekalit dhe Thethit, kryejnë procesin mësimor në kushte tejet optimale.

Po ashtu kemi nisur punën për ndërtimin e një qendre rinore publike multifunktionale në qytet e cila do të jetë e para dhe e vetmja e këtij lloji në vend.

Në këtë periudhë të vështirë sociale dhe ekonomike, ku numri i të papunëve, i familjeve në vështirësi ekonomike dhe i problemeve sociale është në rritje, në jemi përpjekur të mjekojmë sa të mundim problemet e thella sociale të familjeve shkodrane, tju qëndrojmë sa më afër atyre që ndodhen në kushte mjerimi, të ndihmojmë të paafetë. Nuk është rastesi që Bashkia jone është nga rajonet me të prekura nga varferia ekstreme dhe braktisja masive e vendit. Me dhimbje konstatoj se ka ende shumë njerëz që vuajnë për bukë në gojë.

Prandaj Bashkia e Shkodrës, brenda mundësive të saja të kufizuara ka hartuar dhe ndërmarrë një plan për t'iu gjendur pranë banorëve që ndodhen në kushte nevojë. E kemi nisur nga krijimi i 7 qendrave komunitare, 5 në qytetin e Shkodrës dhe nga 1 në Dajç dhe Gurin e Zi, të cilat ofrojnë shërbime të ndihmes për familjet dhe individët në nevojë. Më shtesim 7 shtëpi familje, ku 60 persona me aftësi ndryshe, marrin shërbim të plote familjar nga edukatorët dhe stafet e specializuara të Bashkisë. Me mbështetjen e Ambasades së Shteteve të Bashkuara, kemi rikonstruktuar shkollën speciale "3 Dhjetori" dhe "Qendren e Zhvillimit" për personat me aftësi ndryshe. Po ashtu në mbështetje financiare nga fondet tona trupen muzikore të përbërë nga 30 femije dhe të rinj me aftësi ndryshe.

Që të gjithë banorët e bashkisë të mund të realizojnë të drejtat e tyre themelore, për herë të parë gjatë vitit që lamë pas në mbështetje nepermjet rikonstruksionit të shtëpive të tyre, 9

familje të komunitetit rom. Po perfundojme krijimin e 26 apartamenteve sociale për jetimet dhe grata kryefamiljare me shumë fëmijë dhe në nevojë ekstreme. Me përfundimin e këtij projekti me shumë qytetarë në kushte të rënda sociale do të mundin të gëzojnë të drejtën për një jetë normale familjare. Ju jemi gjendur pranë rreth 100 fëmijëve në situatë rrugë nepermjet shërbimeve mbrojtëse dhe rehabilituese. Ndërsa mbi 300 familjeve në nevojë të theksuara ekonomike dhe familjeve të përmytura, ju kemi shërbyer me pako ushqimore dhe veshmbathje.

Pavarishtë se kemi hartuar dhe kemi aplikuar për ndërtimin e 7 qendrave shëndetësore pranë qeverisë dhe nuk jemi financuar për asnjë prej tyre, në kemi mundur të realizojmë ndërtimin e një qendre shëndetësore në Postribë me fonde të siguruar nga donatorë të huaj.

Ne e dimë që nevojat janë shumë më tepër se sa, mundësitë tona po ashtu shumë të kufizuara, por do të vazhdojmë të shërbëjmë me dashuri të madhe.

Shkodra qendër e artit dhe kultures së kombit ka qenë qëllimi ynë sa i përket mbështetjes së jetës kulturore dhe artistike në qytet. Pavarishtë se në një kohë të shkurtër në kemi nderhyrë pothuaj në të gjitha qendrat kulturore dhe artistike në administrimin e Bashkisë Shkoder duke përmirësuar infrastrukturën e këtyre institucioneve dhe duke nxitur gjallërimin e tyre. Rikonstrukcioni i Teatrit Migjeni ishte një detyrim për artedashësit e shumtë të qytetit. Investimet në mobilimin dhe përmirësimin e infrastrukturës të Bibliotekës, "Galerisë së Arteve", "Muzeut Historik" dhe qendrës "Pjetër Gaci", gjithashtu kanë qenë ndërhyrje për promovimin e vlerave të jashtëzakonshme artistike, kulturore dhe historike të Shkodrës.

Qyteti ka me shumë jetë kur teatri "Migjeni" vendos në skenë një premierë, fëmijet dhe prinderit shkodranë janë me të gëzuar ditëve të festivaleve për fëmijë, qyteti ka me shumë ngjyra gjatë orëve të ekspozitave të artëve figurative apo dhe të aktiviteteve të tjera kulturore. Dhe fatmirësisht artistët tanë të mrekullueshëm na e kanë shpërblyer disafish këtë investim. Teatri Migjeni vuri në skenë plot 11 premiera të cilat u ndoqën nga mbi 8600 spektatorë, prej të cilëve rreth 1500 ishin fëmijë dhe të rinj. Mbi 40 aktivitete kulturore janë organizuar nga institucionet artistike nën administrimin e Bashkisë Shkoder këtë vit.

Biblioteka Marin Barleti ka realizuar një botim të parë sic është ajo e revistës "Gegnia" dhe këtë fundviti, pas shumë vitesh harrese, ringjallëm për të mos u ndalur në të ardhmen, festivalin e kenges qytetare Shkodranë "Luleborë", ku 22 krijime të reja pasuruan muzikën e jashtëzakonshme të Shkodrës.

"Vllaznia" e futbollit ka dalë nga agonia dhe është futur në rrugën e ringritjes së saj. Jemi përpjekur për Shkodrën për Sportdashësit e shumtë që nuk e kanë braktisur asnjëherë Vllazninë. Si bashki, jemi i vetmi komunitet që mbështet ekipet zinxhire të Vllaznisë dhe si asnjë qytet tjetër garojmë në kampionate kombëtare në plot 25 disiplina sportive. Këtë vit kemi dalë kampione kombëtare në 9 prej tyre. Investimi në sport është dhe një investim në shëndetin e fëmijëve dhe të rinjve të qytetit. Ndaj përveç ekipeve profesioniste, po mbështesim dhe aktivitete sportive për amatore, me qëllim që sa më shumë të rinj të jetojnë me sport.

Sigurisht që në do mund të kishim bërë shumë më shumë, nëse Shkodra do të trajtohej njësoj si qytetet e tjera dhe nuk do të diskriminohej nga Qeverisja Qendrore. Kemi aplikuar për financim pranë agjencive qeveritare me shumë se 15 projekte zhvillimi dhe nuk jemi mbështetur.

Administrimi dhe menaxhimi i bazuar në ligj dhe transparencë është parim i punës sonë!

Asnjë procedurë tenderuese nuk është gjetur me shkelje nga agjencitë ekzekutive gjatë drejtimit tim. Pas reformës administrative territoriale në jemi e vetmja Bashki e re në vend që nuk kemi asnjë proces gjyqësor të hapur për mosrespektimin e marrëdhënies së punës. KLSH na ka vlerë

suar qe jemi duke permbushur të gjitha penalitetet e trashëguara nga ish njesite administrative qe ju bashkuan Bashkise se Shkodres.

Ne besojmë vërtetë se një sistem taksash vendore të ulta jo vetëm kompenson politikën shumë agresive këto kohë të qeverisë ndaj biznesit, por edhe rrit punë simin, zbut varferinë , si dhe shton të ardhurat në buxhetin e Bashkisë . Për here të pare kemi zbatuar nje skemë përjashtuese dhe lehtësuese për shtresat në nevojë . Dhe në keto kushte mbarëvajtja, pavarësisht se me shumë vështirësi të trashëguara, mund të vinte vetem nga nje administrim i mirë i taksave dhe tarifave qe ne kontribuojmë per qytetin.

Ndershmeria në pune nuk ka qene vetem synim i punes time, por i të gjithë stafit të Bashkise Shkoder. Në të vetmen Bashki në Shqipëri, në 8 njësi administrative në Shkodër janë ngritur dhe funksionojnë zyrat me një ndalese. Menaxhimi i shërbimit permes sistemit informatik të trajtimit të aplikimeve ka rritur eficiencë n, mbi të gjitha ka rritur transparencën dhe luftuar korrupsionin.

Ne nje kohe qe korrupsioni ka nje shtrirje të frikshme dhe në shume raste ai është kthyer në sistemin e vetem të ofrimit të shërbimeve publike, me krenarine e nje qytetareje shkodrane une dua të konfirmoj se puna e Bashkise Shkoder në vitin që lamë pas është realizuar jo vetem me perkushtim por mbi të gjitha me profesionalizem.

Në vitin 2017 prioritet mbeten përmirësimi dhe shtrirja në tërëtor e shërbimeve më të mira publike, administrative dhe sociale, përmirësimi në infrastrukturën e arsimit dhe shërbimet për mirëfunksionimin e strukturave arsimore, zhvillimi lokal permes investimeve publike lokale në infrastrukturë, permes shërbimeve dhe investimeve në fushën e buqësisë dhe turizmit, kulturës, trashëgimisë, artit e sportit si dhe mbështetjes dhe lehtësirave për iniciativa private.

Gjatë vitit 2017 do të aplikojmë pranë agjensice qeveritare për financime të projekteve sipas progameve të zhvillimit lokal, në fushën e infrastrukturës, shëndetësisë, arsimit, dhe inovacionit. Njëkohësisht me donatorët që tashmë kemi filluar bashkëpunimin do të vazhtojmë të projektojmë dhe të realizojmë aktivitete dhe projekte investimi të përbashkëta.

Në vitin 2007 unë besoj që, bashkë me ju, me bashkeqytetarët, me shumë punë e perkushtim do të vazhdojmë dhe përmbushim përgjegjësitë për të administruar, shërbyer dhe zhvilluar Shkodrën.

Unë besoj në kontributin dhe mbështetjen tuaj!

Voltana Ademi
Kryetare

I. Të dhëna demografike për Bashkinë e Shkodrës

Bashkia jonëtashmë përfshin një territor rreth 50 herë më të madh, me një sipërfaqe prej 872.71 km², dhe një popullsi dy herë më e madhe prej rreth 203,633 banorë të regjistruar. Bashkia e re e Shkodrës ka në përbërjen e saj 11 njësi administrative: Shkodër, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Postribë, Pult, Rrethinat, Shalë, Shosh, Velipojë. Ajo ka nën administrimin e saj një qytet dhe 93 fshatra.




Figure 1 Harta treguese Bashkia Shkodër

Përqëndrimi më i madh i popullsisë është në qytetin e Shkodrës me 56% të popullsisë (113,501 banorë), ndërsa për sa i përket njësive administrative, njësia me popullsi më të madhe është ajo e Rrethinave me 23,616 banorë. Njësitë e tjera më të mëdha nisur nga numri i popullsisë janë Guri i Zi me 11 725 banorë, Postriba me 11 682 banorë, Bërdica me 9569 banorë, Velipoja me 9543 banorë dhe Dajçi me 8961 banorë. Tre njësitë e tjera më të vogla për nga numri i popullsisë janë Ana e Malit me 5951 banorë, Pulti me 3207 banorë, si dhe Shalë e Shosh me 5878 banorë.

Tabela 1 Ndarja në Lagje dhe fshatra në Njësitë Administrative të Bashkisë së Shkodrës

Bashkia Shkodër	Nj.A	Fshatrat	Kufizimi Veri	Kufizimi Jug	Kufizimi Lindje	Kufizimi Perëndim
	Shkodër	Qyteti Shkodër 5 Lagje	Rrethina	Bërdicë, Guri i Zi	Rrethina, Guri i Zi	Liqeni i Shkodrës
	Ana e Malit	Oblikë, Babot, Muriqan, Shtuf, Dramosh, Oblikë e Sipërme, Obot, Vallas, Velinaj, Vidhgar	Shkodër	Lumi Buna Dajç	Rrethina	Mali i Zi
	Bërdicë	Bërdicë e Madhe, Bërdicë e Mesme, Bërdicë e Sipërme, Trush, Beltojë, Mali Hebaj	Shkodër	Bushat	Guri i Zi Lumi Drin	Dajç
	Dajç	Dajç, Samrisht i Ri, Samrisht i Sipërm, Belaj, Mali i Gjymtit, Pentar, Rrushkull, Mushan, Darragjat, Suka-Dajç, Shirq	Lumi Buna Ana e Malit Mali i Zi	Velipojë	Bërdicë Bushat	Lumi Buna
	Guri i Zi	Guri i Zi, Juban, Ganjollë, Kuç, Rrencë, Vukatanë, Gajtan, Rragam, Sheldi, Mazrek, Shpor	Postribë Shllak	Bushat Vau i Dejës	Vau i Dejës	Bërdicë Shkodër
	Postribë	Mes, Dragoç, Boks, Kullaj, Myselim, Drisht, Ura e shtrenjtë, Domen, Shakotë, Prekal, Vilëz	Pult Malësi e Madhe	Guri i Zi	Shllak	Rrethina
	Pult	Pog, Kir, Gjuraj, Plan, Xhan, Bruçaj, Mgull	Shalë Malësi e Madhe	Postribë Shllak	Shosh Shalë	Malësi e Madhe
	Rrethinat	Dobraç, Grudë e Re, Shtoj i Ri, Guci e Re, Shtoj i vjetër, Zues, Golem, Hoti i Ri, Bleran, Bardhaj	Gruemirë	ShkodërGuri i Zi	Postribë	Liqeni Shkodër
	Shalë	Breg-Lumi, Abat, Nicaj-Shale, Lekaj, Vuksanaj, Pecaj, Theth, Ndërlyasaj, Gimaj, Nënnavriq, Lotaj	Kosove	Shosh Tropojë	Tropojë	Malësi e Madhe Pult
	Shosh	Ndrejaj, Nikaj-Shosh, Palaj, Pepsumaj, Brashtë	Shalë	Temal Shllak	Pult	Temal Tropoje Vau i Dejës
	Velipojë	Velipojë, Pulaj, Luarzë, Baks-Rrjoll, Gomsiqe, Baks i Ri, Pulaj, Reç i Ri, Ças, Mali Kolaj	Dajç	Deti Adriatik	Lezhe	Lumi Buna


Bashkia Shkodër është qendra e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë së veriut, kjo për shkak të trashëgimisë, shpirtit sipërmarrës që karakterizon popullsinë si dhe vendndodhjes gjeografike. Qyteti i Shkodrës si qendër e zhvillimit të rajonit të veriut mban rolin e motorit të rritjes ekonomike edhe për njësitë e tjera administrative që e përbëjnë atë. Aktualisht sipërmarrjet dhe ndërmarrjet e vogla e të mesme janë burimi kryesor i të ardhurave ekonomike.

Struktura e punësimit sipas sektorëve:

Struktura e punësimit sipas sektorëve i referohet periudhës gjatë viteve 2015 - 2016:

- 25.5 % e punëtorëve janë të punësuar në sektorin publik;
- 74.5% e punëtorëve janë të punësuar në sektorin publik privat.
-

Papunësia: Niveli i lartë i informalitetit, emigracioni, personat në moshë pune të cilët nuk figurojnë të regjistruar vështirësojnë vlerësimin real të papunësisë në vend. Bazuar në të dhënat paraprake të marra nga Drejtoria Rajonale e Punësimit për vitin 2015 – 2016 rezulton se numri i të papunëve 19-64 vjeç në Shkodër vlerësohet të jetë 7840 persona. Nga analiza e strukturës së papunësisë sipas grupmoshave, shkalla e papunësisë për popullsinë në moshë punë 19-39 vjeç është 35%, ndërsa përqindja e të papunëve të regjistruar të grupmoshës mbi 45 vjeç është më e lartë. Kjo ka lidhje me kërkesat në rritje të tregut të punës për mosha relativisht të reja.



Grafiku 1 Shkalla e papunësisë sipas grupmoshave 2015 – 2016

II. Buxheti i Bashkisë për Vitet 2017-2019.

Hartimi i buxhetit për vitet 2017-2019 është bërë bazuar në ligjin Nr.139/2015, ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligji nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.8 datë 29.03.2012 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afat-mesem", udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.4, datë 29.02.2016 "Për përgatitjen e programit buxhetor afat-mesem 2017-2019" si dhe shkresës së Ministrisë së Financave datë 29 dhjetor 2016 mbi buxhetin vendor 2017

Sipas kërkesave të percaktuara në udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.4/1, datë 29.02.2016, Kryetari i Bashkisë ka miratuar kalendarin e hartimit të Programit Buxhetor Afat-Mesem (PBA), duke percaktuar veprimtarinë e punës të Ekipeve të Menaxhimit të Programit (EMP), si me poshte vijon:

- Propozimin e strukturës së programeve duke siguruar përfshirjen brenda një programi shpenzimesh të funksioneve kryesore të njësisë.
- Shpërndarjen tek çdo Ekip i Menaxhimit të Programit të udhëzimeve të brendshme të nënshkruara nga titullari në lidhje me zbatimin e procedurave të programit buxhetor afatmesëm duke përfshirë dhe ndihmen e ekspertëve të dldp-se.
- Diskutimin me drejtuesit e programeve për dokumentin e risqeve të paraqitur prej tyre dhe përcaktimin e risqeve prioritare për t'u diskutuar në Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS).
- Nënshkrimin e të gjithë raporteve të përgatitjes së kërkesave buxhetore për përdorim të brendshëm të njësisë në lidhje me Rishikimin e Politikës së Programit dhe Planifikimin e Shpenzimeve të Programit.
- Prezantimin tek Kryetari i Grupit të Menaxhimit Strategjik të të gjithë dokumentacionit të kërkesave buxhetore.

Në bazë të urdherit të Kryetarit janë miratuar programet dhe funksionet të cilat do të përfshihen në Programin Buxhetor afat-mesem 2017-2019.

Llogaritja e nivelit të transfertes së pakushtezuar është bërë në bazë të udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.4/1, datë 29.02.2016 me nga 2 % rritje në çdo vit.

Nga Ekipeve të Menaxhimit të Programeve të ngritura në bazë të vendimeve të GMS fillimisht u bë vlerësimi i programeve lidhur me planifikimin e buxhetor për periudhën 2017-2019, mbi bazën e:

- Analizës së tendencës së të ardhurave (të ardhurat gjithsej një vit më parë, viti aktual dhe për tre vitet e ardhshme).
- Analizës së politikave dhe objektivave të programeve sipas funksioneve të veta, të deleguara dhe atyre specifike duke marrë në konsideratë të dhënat financiare të një viti më parë, vitit aktual dhe parashikimin dhe planifikimin për tre vitet e ardhshme.
- Analizës së shpenzimeve operative (një vit më parë, viti aktual dhe për tre vitet e ardhshme).
- Analizës së parashikimit të shpërndarjes së burimeve financiare për periudhën 2017-2019 sipas çdo programi dhe funksioni (për tre vitet e ardhshme).
- Prioritetet të konsultuara të investimeve në fushën e infrastruktures publike.
- Analizës së vlerësimit të projekteve dhe lidhjen e tyre me programet e shpenzimeve publike.
- Analizës së shërbimeve të mirembajtjes së objekteve arsimore, administrative, rrugëve të brendshme dhe atyre rurale.
- Analizës së shpenzimeve të funksioneve specifike të deleguara në vitin 2016.

Një qeverisje vendore, e ndjeshme nga ana gjinore, merr parasysh nevojat, interesat, përparësitë dhe shqetësimet e ndryshme të grave dhe burrave, vajzave dhe djemve, si qytetarë.

Ajo shfrytëzon këto nevoja të ndryshme për t'i integruar në të gjitha proceset e qeverisjes vendore, të tilla si hartimi i politikave, planifikimi, shpërndarja e buxhetit, zhvillimi i programit, dhënia e shërbimeve sociale dhe monitorimi i rendimentit - në mënyrë që të trajtojë drejtpërdrejtë pabarazitë

gjinore ekzistuese. E përkthyer në terma treguesish do të thotë vëmendje më e madhe ndaj:

1. Pjesëmarrjes, përfaqësimit dhe mundësive ekonomike të grave dhe burrave (barazia në paga, përqindja e barabartë e grave dhe burrave në pozita të larta drejtuese)
2. Qasjes në arsim
3. Shëndeti dhe mbijetesa (jetëgjatësia për meshkujt dhe femrat, cilësia e jetës për të dyja gjinitë)
4. Pushteti politik (respektimi i kuotave gjinore në pozita drejtuese)
5. Shërbimet sociale dhe infrastrukturore që mbulojnë nevojat për të dyja gjinitë.
6. Mundësi të barabarta.

Viti 2016, për Bashkinë e Shkodrës ka qenë një vit ndryshimesh të mëdha. Bashkia e re e Shkodrës tashmë përbëhet nga një territor rreth 50 herë më i madh i shtrirë nga Alpet (Thethi) deri në plazh (Velipojë) dhe gjithashtu ka popullsi të dyfishuar. Për t'ju përgjigjur më së miri nevojave dhe problematikave, të të gjitha kategorive, përmirësimit të cilësisë së jetës për banorët e bashkisë së Shkodrës, meshkujve dhe femrave, vajzave dhe djemve, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi ligjit nr. 9970, datë 24.7.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri", Strategjisë kombëtare për barazinë gjinore, dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, etj. është kushtuar vëmendje buxhetimit gjinor dhe shërbimeve sociale.


Në këtë kuadër, për vitin 2016 përmendim:

- Bashkia e Shkodrës ka hartuar planin e veprimit gjinor.
- Bashkia e Shkodrës ka përgatitur Planin Social të Zonës, si një instrument i rëndësishëm në orientimin e politikave sociale që ofrohen në territor nga institucionet publike dhe organizatat e shoqërisë civile. Pjesë e rëndësishme e këtij instrumenti është promovimi i pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave në jetën sociale dhe ekonomike, duke përmirësuar kështu fuqizimin e grave, barazisë gjinore dhe respektimin e të drejtave të tyre njerëzore.
- Në vitin 2016 Bashkia e Shkodrës ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me organizatën "CIES - Centro Informazione ed Educazione allo Sviluppo ONLUS". Qëllimi i kësaj marrëveshje është rritja e kapaciteteve të punonjësve të bashkisë mbi temën e "bilancit gjinor" me synim ngritjen e aftësive dhe kapaciteteve të nevojshme për përfshirjen e një prespektive gjinore në procesin e përcaktimit të bilancit bashkiak dhe buxhetimit të ndjeshëm gjinor gjatë hartimit të projekt-buxhetit të Bashkisë.
- Është krijuar shërbimi social në komunitet. Bashkia e Shkodrës ka në pronësinë e saj, pesë Qendra komunitare. Gjatë vitit 2016, bashkia ka marrë menaxhimin e këtyre qendrave komunitare; janë ngritur dhe janë vënë në funksion duke ofruar shërbime të mirëfillta. Këto Qendra janë quajtur "Qendra komunitare për familjen" dhe mbulojnë 5 rajonet e zonës urbane të qytetit të Shkodrës dhe gjithashtu njësinë administrative Dajç dhe Gur të Zi. Krijimi dhe funksionimi i këyre qendrave është realizuar në përputhje me nevojat e komunitetit në tërësi.
- Planifikimi i shërbimeve publike, është realizuar sipas qasjes gjinore; shërbime dhe investime që i përgjigjen njëlloj të dyja gjinive; mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve urbane, prodhimi, trajtimi, transmetimi dhe furnizimi me ujë të pijshëm, shërbimi i dekorit publik dhe ndriçimi i mjediseve publike duke ndikuar kështu drejt për drejtë në sigurinë e vajzave dhe grave, banore në territorin e Bashkisë së Shkodrës.

Sa më sipër, edhe në hartimin e projekt buxhetit për vitet 2017 – 2019, Bashkia e Shkodrës, në zbatim të ligjit për barazinë gjinore dhe udhëzimeve përkatëse, është mbështetur dhe ka kushtuar vëmendje buxhetimit të ndjeshëm gjinor.

Shkolla shqiptare e Administratës publike me shkresën nr. 237, datë 01.07.2016, i është drejtuar të gjitha Bashkive pjesëmarrëse në kursin e trajnimit 1-vjeçar “Menaxhimi i financave Publike” në nivel vendor. Me anë të kësaj shkrese, kjo shkollë në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të Republikës së Shqipërisë, në vazhdim të trajnimit për planifikimin strategjik dhe menaxhimin e financave publike u sugjeron të gjitha bashkive konsultimin me praktikën e mirë të buxhetit vjetor të Bashkisë së Shkodrës për vitin 2016.

Kjo praktikë e mirë e Bashkisë së Shkodrës ka shërbyer si një instrument më tepër në veprimtarinë profesionale të stafëve të Bashkive në Shqipëri.




Grafiku 2. Buxheti sipas burimeve të financimit

Buxheti i Bashkisë së Shkodrës për vitin 2017 është 2,512,289 mijë lekë, ndër të cilat 621,633 mijë lekë (25%) nga të ardhurat e veta, 555,124 mijë lekë (22%) transfertë e pakushtëzuar, 318,428 mijë lekë (13%) transfertë specifike, dhe 1,017,104 mijë lekë (40%) transfertë e kushtëzuar.

Disa tregues të rëndësishëm për buxhetin

- Të ardhurat nga taksat janë 343,004 mijë lekë dhe zënë 56% të totalit të të ardhurave nga burimet e veta vendore.
- Të ardhurat nga tarifat vendore janë 254,341 mijë lekë dhe zënë 41% të totalit të të ardhurave nga burimet e veta vendore.
- Të ardhurat nga burime të tjera janë 18,701 mijë lekë dhe zënë 3% të totalit të të ardhurave nga burimet e veta vendore.
- Totali i shpenzimeve kapitale është 298,297 mijë lekë dhe zë 25% % të totalit të shpenzimeve të financuara nga burimet e bashkisë.
- Totali i shpenzimeve operative është 559,272 mijë lekë dhe zë 38% të totalit të shpenzimeve të financuara nga burimet e bashkisë.
- Totali i shpenzimeve për paga dhe sigurime është 604,247 mijë lekë për të gjitha funksionet e veta, të deleguara dhe të transferuara, nga të cilat 360,001 mijë lekë (31%) që financohen nga burimet e veta.



Grafiku 3 Plani buxhetor sipas programeve

Tabela 2 Planifikimi për vitin 2017- 2019 sipas programeve buxhetore


	Programet buxhetore	Buxheti 2017	Buxheti 2018	ne /000 lekë Buxheti 2019
P1.	Planifikim Menaxhim Administrim	308,087	357,226	338,302
P2.	Planifikim, administrim dhe kontroll territori.	7,246	5,250	3,600
P3.	Infrastruktura rrugore	174,989	191,652	200,153
P4.	Shërbimet publike	330,555	348,563	358,689
P.5	Transporti publik dhe lëvizshmëria (mobiliteti)	15,312	13,412	18,912
P.6	Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit	14,900	31,110	27,270
P7	Bujqësia dhe zhvillimi rural	32,505	28,947	29,026
P8	Mjedisi dhe mbrojtja e Pyjeve e kullotave.	12,434	12,529	13,126

P9	Arsimi parauniversitar dhe edukimi	357,231	391,031	395,919
P10	Strehimi dhe Shërbimet sociale	65,555	69,858	71,112
P10/1	Ndihma ekonomike dhe PAK	958,958	990,123	1,010,000
P11	Kultura dhe shërbimet rekracionale	87,216	83,108	84,052
P12	Rinia dhe Sportet	97,227	53,838	54,155
P13	Emergjencia Civile	44,074	39,757	40,473
	Fondi rezervë	6,000		
	TOTAL I SHPENZIMEVE	2,512,289	2,616,404	2,644,789

Tabela 3 Planifikimi i buxhetit sipas klasifikimit ekonomik

Programe	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Subvensioni	Transferta	Investime	Fondi rezervë	Totali
TOTALI 2017	604,247	559,272	3,000	1,041,473	298,297	6,000	2,512,289
TOTALI 2018	666,393	582,612	3,000	1,028,186	336,213		2,616,404
TOTALI 2019	679,887	600,692	3,000	1,049,857	311,353		2,644,789

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik
ne raport me burimet e financimit nga te ardhurat e veta




Grafiku 4 Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik Viti 2017

Tabela 4 Planifikimi i shpenzimeve sipas funksioneve për vitin 2017

Funksionet	Plani 2017
Ndihma ekonomike dhe PAK	958,758
Arsimi parashkollor parauniversitar	357,231
Administrata vendore	308,087
Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve urbane;	180,249
Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore, trotuareve dhe shesheve publike vendore;	167,389
Organizimi i aktiviteteve sportive dhe rekreacionale, zhvillimi dhe administrimi i institucioneve dhe objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.	95,061
Ndriçimi i mjediseve publike	82,312
Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i vlerave dhe trashëgimisë kulturore me interes lokal si dhe administrimi i objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.	60,288
Ndërtimi dhe administrimi i qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale lokale.	44,816
Emergjencat civile	44,074
Parqet, lulishtet dhe hapësirate gjelbra publike;	40,502
Administrimi i infrastrukturës vendore të ujitjes dhe kullimit të tokave si dhe menaxhimi i institucioneve në shërbim të këtij funksioni, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;	32,505
Zhvillimi, mbrojtja, dhe promovimi i bibliotekave dhe ambienteve për lexim me qëllimin e edukimit të përgjithshëm të qytetarëve.	26,928
Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e varrezave publike si dhe garantimi i shërbimit publik të varrimit;	21,371
Në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, krijojnë fondin social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.	18,850
Transporti publik vendor	15,312
Menaxhimi i sistemit të ujërave të shiut	12,600
Administrimin e pyjeve dhe kullotave vendore si dhe menaxhimin e institucioneve në shërbim të këtij funksioni, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.	12,434
Planifikimi, administrimi dhe kontrolli i territorit sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.	7,246
Ngritja dhe funksionimi i tregjeve publike	6,500
Fondi rezerve	6,000
Zhvillimi i Turizmit	5,850
Programet/projektet rinore	2,166
Ndërtimi dhe administrimi i banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.	2,089
Dhënie e granteve dhe ndihmave financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël dhe të mesëm, sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi.	1,600
Shërbimi i dekorit publik;	1,121
Mbështetja për zhvillimin e biznesit të vogël nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panairë e reklama në vende publike;	650
Publikim i broshurave informative, krijimit të portaleve me profil ekonomik etj.	300

Plani i shpenzimeve sipas funksioneve për vitin 2017



Grafiku 5 Plani i shpenzimeve sipas funksioneve për vitin 2017

III. Të Ardhurat e Bashkisë për vitet 2017-2019

Sipas nenit 34 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, pika 3 dhe 4, njësitë e vetëqeverisjes vendore financohen nga të ardhurat që sigurohen nga taksat, tarifat dhe të ardhurat e tjera vendore, nga fondet e transferuara nga qeverisja qendrore dhe fondet që u vijnë drejtpërdrejt atyre nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacione, si dhe burime të tjera, të parashikuara në ligj. Njësitë vendore u garantohet me ligj e drejta për krijimin e të ardhurave në mënyrë të pavarur.


Të ardhurat e përgjithshme të Bashkisë Shkodër, nga të gjitha burimet e financimit parashikohen të jenë: për vitin 2017, në shumen 2,512,289 mijë lekë, për vitin 2018 në shumen 2,616,404 mijë lekë dhe për vitin 2019 në shumen 2,644,789 mijë lekë.

Këto të ardhura, sipas ligjit të mësipërm, vijnë nga dy burime të ardhurash si më poshtë:

A. Nga burimet e veta vendore, ku përfshihen të ardhurat tatimore (nga taksat vendore), jo tatimore (nga tarifat për shërbimet publike që ofrojnë dhe të ardhurat e tjera vendore), donacione.

B. Nga burimet qendrore, ku përfshihen transfertat e pakushtëzuar, transfertat specifike për funksionet e reja që i janë transferuar Bashkisë dhe transfertat e kushtëzuar.

Te ardhurat gjithsej buxheti 2017



Grafiku 6 Të ardhurat e buxhetit 2017

II.1 Të ardhurat nga burimet e veta vendore

Bashkia Shkodër për vitin 2017, nga burimet e veta vendore duke përfshirë dhe të ardhurat e trashëguara nga viti i mëparshëm, parashikon rreth 621,633 mijë lekë të ardhura të veta.

Tabela e mëposhtme paraqet parashikimin e të ardhurave të veta për Bashkisë Shkodër për vitin 2017-2019 sipas çdo burimi.

Tabela 5 Të ardhurat nga burimet e veta të Bashkisë për vitin 2017-2019

(000/lekë)

Nr.	Të ardhurat e veta	Plan 2017	Plan 2018	Plan 2019
I	Nga burimet e veta vendore	616,046	622,746	632,965
1	Të ardhurat tatimore/taksat	343,004	349,786	356,803
2	Të ardhurat jo tatimore, etj.	273,042	272,960	276,162
II	Të ardhura të trashëguara nga viti i mëparshëm	5,587		
	TOTALI	621,633	622,746	632,965

Të ardhurat nga burimet e veta vendore përbëjnë burimin kryesor të të ardhurave me parashikim prej 621,633 mijë lekë për vitin 2017, 622,746 mijë lekë për vitin 2018 dhe 632,965 mijë lekë për vitin 2019, dhe zënë mesatarisht 25 % të totalit të të ardhurave gjithsej nga të gjitha burimet të Bashkisë Shkodër.

Krahasuar me të ardhurat e veta, ku përfshihet edhe transferta e pakushtëzuar zë mesatarisht 47.2%- 47.6 % të totalit të të ardhurave.

II.2 Të ardhurat nga burimet qendrore

Të ardhurat nga burimet qendrore përfshijnë të ardhurat nga transferta e pakushtëzuar, transferta specifike, transferta e kushtëzuar.


Tabela 6 Të ardhurat nga burimet qendrore

/mijë lekë

Transferta e pakushtëzuar	555,124	566,227	575,551
Transferta specifike	318,428	324,793	331,293
Transferta e kushtëzuar	1,017,104	1,102,638	1,104,980
TOTAL	1,890,656	1,993,658	2,011,824

Të ardhurat nga burimet qendrore janë 1,890,656 mijë lekë për vitin 2017, 1,993,658 mijë lekë për vitin 2018, dhe 2,011,824 mijë lekë për vitin 2019, dhe përfshijnë transfertën e pakushtëzuar dhe atë specifike për funksionet e reja si dhe transfertën e kushtëzuar.

Te ardhurat nga burimet qendrore 2017




Grafiku 7 Të ardhurat nga burimet qendrore për vitin 2017

Për vitet 2017-2019 krahas transfertës së pakushtëzuar akordohet edhe fondi i transfertës specifike për funksionet e reja prej 318,428 mijë lekë për 2017, 324,793 mijë lekë për 2018 dhe 331,293 mijë lekë për 2019.

Tabela 7 Transferta specifike përkatësisht sipas funksioneve të transferuara

Nr	TRANSFERTA SPECIFIKE	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019
1	Konviktet e arsimitparauniversitar	56,878	58,015	59,176
2	Arsimiparauniversitar	19,963	20,362	20,770
3	Arsimiparashkollor	143,889	146,766	149,702
3	Mbrojtjangazjarridheshpëtimi	30,745	31,359	31,988
2	Mbrojtja Sociale	18,850	19,227	19,612
6	Administrimi i pyjeve	5,307	5,413	5,521
5	Rrugët rurale	18,214	18,578	18,950
7	Ujitja dheKullimi	24,582	25,073	25,574
	TOTALI	318,428	324,793	331,293

Shperndarja e transfertes specifike sipas programeve 2017



Grafiku 8 Shperndarja e transfertes specifike sipas programeve 2017

Tabela 8 Transferta e pakushtëzuar dhe specifike vitet 2016 dhe 2017.

000/lekë

Viti	Transfer ta e pakusht ëzuar	Transferrat specifike për financimin e funksioneve								Totali I transfert es specifike	Totali
		Konviktet e arsimit parauniversita r	Arsimi parashkollor	Arsimi parauniversita r	Mbrojtja nga zjarri	Mbrojtja sociale	Adminis trimi i pyjeve	Rrugë t	Ujitja dhe Kullimi		
2016	490,679	55,763	143,133	19,963	30,678	18,480	3,679	17,857	17,388	306,941	797,620
2017	555,124	56,878	143,889	19,963	30,745	18,850	5,307	18,214	24,582	318,428	873,552
Difer enca	64,446	1,115	756	-	67	370	1,628	357	7,195	11,487	75,933

A. Te ardhurat e veta vendore

Të ardhurat e veta vendore përfshijnë të gjitha burimet e të ardhurave, me përjashtim të transfertës së kushtëzuar. Këto burime të ardhurash bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Specifika e këtyre të ardhurave, sipas nenit 40/1 të ligjit është që nëse nuk shpenzohen brenda vitit fiskal, trashëgohen në vitin tjetër fiskal. Pra, pjesë përbërëse e këtyre të ardhurave janë dhe ato që trashëgohen nga viti i mëparshëm. Planifikimi i të ardhurave nga taksat/tarifat është mbështetur në paketën fiskale të Bashkisë Shkodër, e cila përcakton llojet e taksave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështet e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

Një vit më parë Bashkia Shkodër nisi procesin e hartimit të një sistemi të integruar dhe të aplikueshëm në të gjithë territorin lidhur me nivelin e taksave dhe tarifave vendore për individët dhe biznesin.

Niveli i aplikuar i miratuar i taksave dhe tarifave vendore mori në konsideratë disa aspekte që adresonin problemet e evidencuara pas miratimit të reformës territoriale.

Paketa fiskale e vitit 2016 bëri të mundur aplikimin e niveleve të ndryshme dhe të vlerësuar për numrin dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendore, në njësitë e ndryshme, bazuar mbi:

- Referencën dhe aplikimin e duhur të bazës ligjore;
- Vlerësimin bazë për llojin e shërbimit dhe përkundrejt shërbimit përcaktimin e tarifës për shërbimin e mbledhjes, grumbullimit dhe transportit të mbetjeve urbane;
- Vlerësimin bazë për përcaktimin e nivele të tarifës së ndriçimit rrugor, bazuar mbi nivelin e konsumit të energjisë dhe kostos së mirëmbajtjes së rrugëve

Paketa fiskale e integruar përfshiu:


- a) Rishikimin e kornizës ligjore për përcaktimin e saktë të taksave, tarifave dhe çdo pagese;;
- b) Saktësimin e procedurave, afateve, aktorëve, veprimeve, përgjegjësive për çdo taksë dhe tarifë.
- c) Përcaktimin e qartë dhe ndarjen në seksione të taksave nga tarifave. Çdo taksë dhe tarifë është detajuar duke patur në konsideratë elementët:
 - ✓ Klasifikim i biznesit, qarkullim vjetor, lloji i aktivitetit;
 - ✓ Qartësimi dhe përcaktimi i taksave apo tarifave që aplikohen për kategorinë e familjeve nisur nga lloji, vendndodhja etj;
- h) Analiza e taksave që aplikohen për territorin që mbulon, përcaktimin dhe detajimin në kategori, unifikimin e kategorive për të gjitha taksat, përcaktimin e bazës së taksueshme dhe aplikimin e kufijve që përcakton ligji;
- i) Rikategorizimin dhe detajimin e taksave;
- j) Analiza e tarifave që aplikohen për territorin që mbulon njësia, përcaktimin dhe detajimin në kategori, unifikimin e kategorive për të gjitha tarifat, përcaktimin e nivelit të tarifave mbështetur në raportet bazë të vlerësimit të kostos së shërbimit për të cilin vendosen (shërbimi i pastrimit, shërbimi i ndriçimit rrugor);
- k) Aplikimin e incentivave apo lehtësirave fiskale për grupe të caktuara taksapaguesish në nevojë, siç mundëson ligji.

A.1 Të ardhurat nga burimet e veta vendore sipas llojit

Të ardhurat nga burimet e veta vendore përfshijnë të ardhurat nga taksat, të ardhurat nga tarifat dhe të ardhurat nga burime të tjera. Pjesën më të madhe të tyre e përbëjnë të ardhurat nga taksat (61%).

Tabela 9 Të ardhurat nga burimet e veta vendore


	Viti 2017	Viti 2018	/mijë lekë Viti 2019
Të ardhurat nga Burimet e Veta Vendore	616,046	622,746	632,965
Të ardhura nga taksat	343,004	349,786	356,803
Të ardhura nga tarifatat	254,341	257,654	261,012
Të ardhura nga burime të tjera vendore	18,701	15,306	15,150



Grafiku 9 Të ardhurat nga burimet e veta

Zërat e taksave dhe tarifave që ndikojnë pjesën më të madhe të planit të të ardhurave nga burimet e veta për vitin 2016 janë kryesisht taksa e ndikimit në infrastrukturë që zë rreth 20%, tarifatat për pastrimin që zë rreth 22%, taksa e pasurisë së paluajtshme që zë rreth 21%, taksa e mjeteve të përdorura që zë rreth 8%, tarifa e zënies së hapësirës publike që zë rreth 7%, tarifa e ndriçimit publik që zë rreth 5%. Këto zëra kryesorë mbulojnë rreth 74% të planit të të ardhurave të Bashkisë Shkodër.

Ndikimi në planin e të ardhurave i çdo takse dhe tarife



Grafiku 10 Ndikimi në planin e të ardhurave, i çdo takse dhe tarife

Pesha kryesore në realizimin e të ardhurave i ngarkohet Njesisë administrative Shkodër në vlerën 446,386 mijë Lekë, ose 74% të planit total të të ardhurave.

Tabela e mëposhtme pasqyron planin e të ardhurave të veta, të kategorizuar sipas klasifikimit ekonomik ligjor:

Tabela 10 Plani e të ardhurave të veta të Bashkisë Shkodër

PLANIFIKIMI I TË ARDHURAVE PËR VITET 2017, 2018, 2019


000/leke

LLOJET E TË ARDHURAVE	Plani 2016	Fakti pritshëm 2016	Plani 2017	Plani 2018	Plani 2019
TË ARDHURAT NGA BURIMET E VETA GJITHSEJ	600.101	483.666	616.046	622.746	632.965
TË ARDHURA TATIMORE/NGA TAKSAT VENDORE	366.259	238.808	343.004	349.786	356.803
Të ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël	7.275	12.564	7.250	7.323	7.396
Të ardhura nga Taksa biznesit vogel (e prapambetur)	1.377	404	250	125	63
Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme	114.774	101.898	126.374	129.735	133.192
Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat	86.264	90.074	94.946	97.794	100.727
Ndërtesa banimi	24.790	18.903	24.869	25.615	26.383
Ndërtesa të tjera	61.474	71.171	70.077	72.179	74.344
Të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore	18.585	3.204	21.496	21.711	21.928
Të ardhura nga taksa mbi truallin	9.925	8.620	9.932	10.230	10.537
Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel	8.700	10.857	10.914	11.023	11.133
Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë	155.824	43.649	124.000	125.240	126.492
Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë	10.500	5.782	6.500	6.760	7.030
Të ardhura nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura	51.000	47.241	51.000	52.530	54.106
Të ardhura nga taksa e rentës minerare	-	64	60	61	62
Të ardhura nga taksa e tabelës	16.809	16.350	16.656	16.989	17.329
Të ARDHURAT JOTATIMORE	233.842	244.858	273.042	272.960	276.162
Të ardhurat nga Tarifat vendore	214.256	230.256	254.341	257.654	261.012
Te ardhura nga tarifat e pastrimit dhe largimit të mbeturinave	124.009	120.601	135.020	136.665	138.331
Të ardhura nga tarifë pastrimi nga familjet	59.844	42.221	58.860	59.743	60.639
Të ardhura nga tarifë pastrimi nga institucione	250	169	165	167	169
Të ardhura nga tarifë pastrimi nga biznesi	63.915	78.212	75.995	76.755	77.523
Të ardhura nga tarifa për ndriçimin publik	28.163	27.773	28.344	28.628	28.914
Të ardhura nga tarifë për ndriçimin publik nga familje	18.372	15.199	17.076	17.247	17.419
Të ardhura nga tarifë ndricimi nga institucione institucione	75	49	50	51	52
Të ardhura nga tarifë ndricimi nga biznesi	9.716	12.525	11.218	11.330	11.443
Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin	19.166	20.266	19.995	20.195	20.397
Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin nga familjet	9.186	7.651	8.538	8.623	8.709
Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin nga institucionet	75	48	50	51	52
Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin nga biznesi	9.905	12.567	11.407	11.521	11.636
Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë	27.758	45.799	51.323	52.310	53.316
Nga tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit	100	-	10	10	10
Nga tarifa për vulosje veterinerë të bagëtive të therura	280	106	100	101	102
Nga Tarifat e licënsimit të veprimtarive të transportit	1.375	970	1.535	1.550	1.566
Nga tarifa parkimi për mjetet e licënuara, dhe për vendparkime	2.492	4.189	3.739	3.814	3.890
Nga tarifë për dhënie licënsa për tregtimin e naftës	400	-	600	606	612
Nga tarifat në sektorin e pyjeve dhe kullotave.	-	-	200	202	204
Nga tarifat e shërbimeve që kryen struktura e MKZ	1.925	348	1.925	1.964	2.003
Nga tarifa për zënien e hapësirave publike	19.685	40.186	41.714	42.548	43.399
Nga linjat ajrore dhe nëntokësore	1.500	-	1.500	1.515	1.530
Të ardhura nga tarifa të instit. të arsimit, kultures, sportit, etj	15.160	15.817	19.659	19.856	20.054
Biblioteka "Marin Barleti"	100	31	100	101	102
Muzeumet	2.100	1.842	1.700	1.717	1.734
Teatri "Migjeni"	600	2.317	1.000	1.010	1.020
Qendra Kulturorë e fëmijëve	250	75	150	152	154
Pallati sportit "Qazim Dervishi"	1.000	158	500	505	510
Nga dokumentat për tender, ankand etj.	-	-	109	110	111
Nga kopshtet	7.920	7.827	12.300	12.423	12.547
Nga çerdhet	3.190	3.568	3.800	3.838	3.876
TË ARDHURA TË TJERA	19.586	14.602	18.701	15.306	15.150
Të ardhura nga kundrvajtjet administrative	8.850	6.570	7.085	7.156	7.228
Të ardhura nga dhënia me qira e asetëve në pronësi	5.520	3.099	4.075	4.116	4.157
Të ardhura nga sekuestime dhe zhdëmtime	100	710	50	51	52
Të ardhura nga shitja e mallrave dhe e shërbimeve	1.500	1.526	3.140	3.171	3.203
Të ardhura të tjera	-	-	500	505	510
Të ardhura nga sponsorizimet	3.616	2.698	3.851	307	-

A.2 Të ardhurat nga burimet e veta vendore sipas Njësive Administrative

Tabela 11 Ngarkesa fiskale sipas njësive administrative

Planifikimi i të ardhurave për vitet 2017-2019, sipas Njësive Administrative / mijë Lekë																		
		Njësia Administrative Qendër						Njësi Administrative të tjera										
Viti	Totali	Shuma	Lagje nr. 1	Lagje nr. 2	Lagje nr. 3	Lagje nr. 4	Lagje nr. 5	Shuma	Pult	Shosh	Shalë	Postribë	Guri i Zi	Bërdicë	Velipojë	Dajc	Ana e Malit	Rrethina
2017	616.046	423.927	101.183	85.513	84.563	92.969	59.700	192.119	2.057	2.669	2.975	12.150	16.335	17.844	92.388	14.313	9.661	21.725
2018	622.746	428.538	102.283	86.443	85.483	93.980	60.349	194.208	2.079	2.698	3.007	12.283	16.513	18.039	93.392	14.469	9.766	21.961
2019	633.465	435.914	104.044	87.931	86.954	95.598	61.388	197.551	2.115	2.745	3.059	12.494	16.797	18.349	95.000	14.718	9.935	22.339



Grafiku 11 Planifikimi i të ardhurave, sipas njësive administrative

B. Kapacitetet fiskale të taksapaguesve


Paguesit e nivelit të taksave dhe tarifave vendore janë bizneset, institucionet dhe familjet e të gjitha njësive administrative. Për përcaktimin e numrit të tyre janë konsideruar të dhënat për taksapaguesit, si dhe përjashtimet apo lehtësitë fiskale sipas paketës fiskale të miratuar nga këshilli i bashkisë.

Në total numri taksapaguesve është parashikuar rreth 37,222 (familje, biznese dhe institucione). Peshën numerike më të madhe të taksapaguesve e përbëjnë familjet (85% ndaj totalit)

Më poshtë paraqitet tabela përmblledhëse e kapacitetit të taksapaguesve sipas kategorive dhe njësive administrative.

Tabela 12Kapaciteti i taksapaguesve sipas grupeve


KAPACITETI I TAKSAPAGUESVE SIPAS GRUPIMEVE (Numri)					
Nr	Bashkia Shkodër	Familjet	Biznesi i Vogël	Biznesi i madh	Institucione
I	NjA Shkodër	17,780	3.290	959	20
	Lagjia nr.1	3,970	870	249	3
	Lagjia nr.2	3,540	640	185	5
	Lagjia nr.3	3,680	780	217	5
	Lagjia nr.4	3,930	740	217	4
	Lagjia nr.5	2,660	260	91	3
II	NjA të tjera	13,900	1.009	251	13
	NjA Pult	280	5		1
	NjA Shosh	70	5		1
	NjA Shalë	400	13		1
	NjA Postrisë	1,540	88	14	2
	NjA Guri i Zi	1,890	113	16	1
	NjA Bërdicë	1,360	114	33	1
	NjA Velipojë	2,140	337	150	2
	NjA Dajç	1,140	53	3	1
	NjA Ana e Malit	850	41	7	1
	NjA Rrethinat	4,230	240	28	2
	TOTALI	31,680	4.299	1.210	33



Grafiku 12 Taksapaguesit

B.1 Taksapaguesit familjarë

Në total numri i familjeve që parashikohet të përfshihen në skemën e detyrimeve fiskale të bashkisë Shkodër është 31,680. Numri i familjeve në njësinë administrative Shkodër zë peshën kryesore me 17,780 familje ose 56% të numrin të përgjithshëm të familjeve në Bashkinë Shkodër.



Grafiku 13 Numri i familjeve taksapaguese


Parashikimi i të ardhurave nga familjet është bërë duke ju përafëruar kapaciteteve reale të familjeve rezidente dhe duke mesatarizuar numrin e arkëtimit në vitet e kaluara sipas zonave me numrin e familjeve sipas censurit.

Në planin e të ardhurave janë parashikuar lehtësi fiskale për familjet me probleme sociale, si për familjet që janë përfitues të ndihmës ekonomike, për pensionistët, për invalidët etj., të cilët përbëjnë rreth 9,860 familje ose 31% të familjeve taksapaguese.

Më poshtë tabela përmbledhëse për familjet sipas kategorive/lehtësive fiskale dhe sipas Njësive Administrative:

Tabela 13 Kapaciteti i familjeve taksapaguese

KAPACITETI I FAMILJEVE TAKSAPAGUESE					
Nr	Bashkia Shkodër	Totali i familjeve	Familje me tarifa/taksa të plota	Familje me lehtësi fiskale	
				Pensionistë, invalidë, etj.	Përfitues të ndihmës ekonomike
I	NjA Shkodër	17,780	12,330	3,790	1,660
	Lagjia nr.1	3,970	2,760	850	360
	Lagjia nr.2	3,540	2,440	750	350
	Lagjia nr.3	3,680	2,570	790	320
	Lagjia nr.4	3,930	2,740	840	350
	Lagjia nr.5	3,660	1,820	560	280
II	NjA të tjera	13,220	9,490	1,650	2,760
	NjA Pult	280	50	30	200
	NjA Shosh	70	20	20	30
	NjA Shalë	400	80	20	300
	NjA Postribë	1,540	900	100	540
	NjA Guri i Zi	1,890	1,250	200	440
	NjA Bërdicë	1,360	950	180	230
	NjA Velipojë	2,140	2,000	80	60
	NjA Dajc	1,140	900	150	90
	NjA Ana e Malit	850	540	130	180
	NjA Rrethinat	4,230	2,800	740	690
	TOTALI	31,680	21,820	5,440	4,420



Grafiku 14 Familje me lehtësi fiskale

B.2 Taksapaguesit biznese dhe institucione

Bazuar në regjistrat aktual, në total, numri i bizneseve që parashikohet të përfshihen në skemën e detyrimeve fiskale të bashkisë Shkodër është 5,509. Biznesi i vogël zërreth 78% të numrit total të bizneseve.


Numri i institucioneve që përfshihen në detyrimet fiskale janë rreth 33, ndër të cilat rreth 60% e tyre ndodhen në Njësinë Administrative Shkodër.

Më poshtë paraqitet tabela përmbledhëse për bizneset sipas xhiros, sipas institucioneve dhe Njësive Administrative:

Tabela 14 Kapaciteti i bizneseve dhe institucioneve taksapaguese

KAPACITETI I BIZNESEVE DHE INSTITUCIONEVE TAKSAPAGUESE						
Nr	Bashkia Shkodër	Totali	Totali i bizneseve	Nga kjo		Institucione
				Biznesi i vogël	Biznesi i madh	
I	NjA Shkodër	4,269	4,249	3,290	959	20
	Lagjia nr.1	1,122	1,119	870	249	3
	Lagjia nr.2	830	825	640	185	5
	Lagjia nr.3	1,002	997	780	217	5
	Lagjia nr.4	951	957	740	217	4
	Lagjia nr.5	354	351	260	91	3
II	NjA të tjera	1,273	1,260	1,009	251	13
	Pult	7	5	5	-	1
	Shosh	7	5	5	-	1
	Shalë	15	13	13	-	1
	Postribë	104	102	88	14	2
	Guri i Zi	129	129	113	16	1
	Bërdicë	147	147	114	33	1
	Velipojë	489	487	337	150	2
	Dajç	56	56	53	3	1
	Ana e Malit	49	48	41	7	1
	Rrethinat	270	268	240	28	2
TOTALI		5,542	5,509	4,299	1,210	33

Numri i bizneseve taksapaguese



Grafiku 15 Numri i bizneseve

Në tabelën e mëposhtme, për bizneset e vogla vihet re pesha e madhe që zë aktiviteti tregtar dhe shërbime me 84% ndaj totalit të bizneseve të vegjël.


Tabela 15 Kapaciteti i bizneseve të vegjël sipas natyres

KAPACITETI I BIZNESEVE TË VEGJEL SIPAS NATYRES SE TYRE					
Nr	Bashkia Shkodër	Biznesi i vogël	Nga kjo :		
			Njësi tregëtare dhe shërbimi	Njësi prodhimi	Ambulantë
I	NjA Shkodër	3,290	3,000	170	120
	Lagjia nr.1	870	810	50	10
	Lagjia nr.2	640	600	30	10
	Lagjia nr.3	780	660	40	80
	Lagjia nr.4	740	690	40	10
	Lagjia nr.5	260	240	10	10
II	NjA të tjera	1,009	953	56	-
	Pult	5	5	-	-
	Shosh	5	5	-	-
	Shalë	13	13	-	-
	Postribë	88	88	-	-
	Guri i Zi	113	100	13	-
	Bërdicë	114	114	0	-
	Velipojë	337	307	30	-
	Dajc	53	50	3	-
	Ana e Malit	41	38	3	-
	Rrethinat	240	233	7	-
	TOTALI	4,299	3,953	226	120

Në tabelën e mëposhtme, për bizneset e mëdha, vihet re pesha e madhe që zë aktiviteti tregtar dhe shërbime me 76% ndaj totalit të bizneseve të mëdhenj.

Tabela 16 Kapaciteti i bizneseve të mëdha sipas natyrës së tyre

KAPACITETI I BIZNESEVE TË MËDHA SIPAS NATYRËS SË TYRË							
Nr	Bashkia Shkodër	Biznesi i madh	Nga kjo :				
			Njësi tregëtare dhe shërbimi	Njësi tregtare për tregëtim karburanti	Njësi prodhimi	Subjekte ndërtimi	Ente shtetërore, OJF, etj.
I	NJA Shkodër	959	750	26	80	33	70
	Lagjia nr.1	249	200	7	20	8	14
	Lagjia nr.2	185	150	5	10	6	14
	Lagjia nr.3	217	170	6	20	7	14
	Lagjia nr.4	217	170	6	20	7	14
	Lagjia nr.5	91	60	2	10	5	14
II	NJA të tjera	251	219	17	9	6	-
	Pult	-	-	-	-	-	-
	Shosh	-	-	-	-	-	-
	Shalë	-	-	-	-	-	-
	Postribë	14	11	3	-	-	-
	Guri i Zi	16	12	1	2	1	-
	Bërdicë	33	29	3	-	1	-
	Velipojë	150	145	2	2	1	-
	Dajç	3	2	1	-	-	-
	Ana e Malit	7	5	2	-	-	-
	Rrethinat	28	15	5	5	3	-
	TOTALI	1.210	969	43	89	39	70



Grafiku 16 Kapaciteti i bizneseve të vegjel sipas natyres

C. Analiza e të ardhurave të veta vendore dhe ndikimet e tyre në të ardhurat e bashkisë

Të ardhurat nga burimet e veta vendore përfshijnë të ardhurat nga taksat vendore, nga tarifat për shërbimet publike dhe të ardhurat e tjera vendore.

Sipas ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 35/2, bashkitë e ushtrojnë të drejtën e vendosjes së nivelit të taksës, mënyrën e llogaritjes së saj, si dhe mbledhjen e administrimit të tyre brenda kufijve e sipas kriterëve të përcaktuara me ligj.

Llogaritja e të ardhurave të kësaj kategorie mbështetet në:

1. Ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar;
2. Ligjin nr.9920 datë 26.05.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar ;
3. Vendimin e Këshillit të Bashkisë Shkodër nr 1 date 22.01.2016 "Për miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Shkodër", i ndryshuar;

C.1 të ardhurat nga taksat vendore


Ligji nr 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", me ndryshimet përkatëse, përbën ligjin bazë i cili përcakton rregullat për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të njësive të qeverisjes vendore në drejtim të taksave vendore, mbledhjes dhe administrimit të tyre.

Paketa fiskale e bashkisë Shkodër për këtë kategori e hartuar dhe e ndryshuar edhe me përfshirjen e përfaqësuesve të komunitetit të biznesit e më konkretisht biznesit të madh (juridik) dhe të vogël (fizik), banorëve të njësive administrative, përfaqësues të komunitetit sipas interesit dhe këshilltarë, pasqyron disa politika të rëndësishme për uljen e disa niveleve ligjore/kufi, etj. sipas kompetencave ligjore, si më poshtë:

- Ulje e taksës së ndërtesës për qëllime banimi deri në 30% nga referenca ligjore
- Taksë 0 (zero) ndërtese për qëllime banimi për invalidët
- Ulje e taksës së ndërtesës për qëllime biznesi etj. deri në 30% nga referenca ligjore
- Ulje në nivelin maksimal të lejuar prej 30% të taksës së tokës bujqësore
- Nivelin minimal ligjor për taksën e ndikimit në infrastrukturë

Për vitet 2017-2019 parashikohet që të ardhurat nga taksat të përbëjnë rreth 53% të të ardhurave nga burimet e veta të bashkisë.

Pjesë e rëndësishme në këtë kategori të taksave vendore janë të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë, e cila zë mbi 43% të totalit dhe më pas vijnë të ardhurat nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme (31%) dhe më pas të ardhurat nga taksa e mjeteve të përdorura (14%).



Grafiku 17Pesha sipas zërave e të ardhurave nga taksat vendore

Të ardhura nga Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël

Sipas ligjit 142/2015 dt 17.12.2015, “Për disa ndryshime dhe shtesa me ligjin 9632, date 30/08/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 11:

- shkalla tatimore për subjektet me xhiro nga 0 deri në 5 milion është 0 Lekë,
- ndërsa shkalla tatimore për subjektet me xhiro nga 5 milion deri në 8 milion është 5 % e fitimit.

Tatimi i thjeshtuar për biznesin e vogël administrohet nga Drejtoria Rajonale Tatimore, e cila në rolin e agjentit tatimor mban një komision prej 1% të vlerës së grumbulluar, ndërsa 99% kalon në favor të bashkisë Shkodër.

Të ardhurat nga Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël për vitin 2017-2019 parashikohen të jenë 7,250 mije lekë/vit.

Tabela 17Të ardhura nga Tatimi i thjeshtuar

Të ardhura nga Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël 000/lekë

	Me xhiro vjetore nga 0 - 5.000.000 lekë		Me xhiro vjetore nga 5.000.001 – 8.000.000 lekë		Totalii të ardhurave
	Niveli i tatimit	Te ardhurat	Niveli i tatimit	Te ardhurat	
2017	0	0	5% e fitimit	7,250	7,250
2018	0	0	5% e fitimit	7,323	7,323
2019	0	0	5% e fitimit	7,396	7,396

Të ardhura nga Taksa mbi pasurinë e paluajtshme

Këto të ardhura përfshijnë të ardhurat nga :

- Taksa mbi ndërtesat (mbi ndërtesat e banimit dhe mbi ndërtesat e tjera)
- Taksa mbi tokën bujqësore
- Taksa mbi truallin

a) Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat

Taksa mbi ndërtesat e banimit

Baza e taksës është sipërfaqja e ndërtimit në metër katror e ndërtesës ose e pjesës së saj mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për çdo kat.

Parashikimi për vitet 2017-2019 bazohet të zgjerimi i bazës së taksapaguesve nëpërmjet:

- saktësimi dhe vlerësimi të drejtë të sipërfaqeve nëpërmjet grupeve të punës të ngritura për këtë qëllim.
- rritjes së efikasitetit të agjentit tatimor duke implementim të programeve të kompjuterizuar,
- ndarjes në këste të pagesave,
- krijimit të arkave funksionale të agjentit tatimor më pranë zonave të banuara në njësitë administrative.

Bashkia Shkodër parashikon që të gjejë mbështetje edhe tek institucionet e tjera si Zyra vendore e regjistrimit të pasurisë për saktësimin dhe përpilimin e një regjistri sa më të saktë të banesave në territorin e saj.

Duke u krahasuar me referencën ligjore, niveli i taksës së ndërtesave të banimit sipas paketës fiskale ka një lehtësim deri në 30% në zonat urbane, dhe deri në 17% në zonat rurale.

Planifikimi i të ardhurave është bërë duke u bazuar tek të dhënat e Censurit, si dhe duke iu referuar tendencës në rritje të kapacitetit të realizimit të të ardhurave ndër vite. Të ardhurat nga taksa për ndërtesat e banimit për vitin 2017 parashikohen në vlerën 24,869 mijë Lekë, për vitin 2018 me vlerë 25,615 mijë Lekë e për vitin 2019 me vlerë 26,383 mijë lekë, me një rritje prej 3% në vit.


Më poshtë paraqitet tabela e të ardhurave nga taksa mbi ndërtesat e banimit, sipas grupeve të njësive administrative:

TE ARDHURAT NGA TAKSA MBI NDERTESAT E BANIMIT /000/lekë

I.2. 1.1	Kategorite e Ndertesave të Banimit	NjA Shkodër			NjA Velipojë			NjA të tjera			Total e ardhur	Totali I Siperfaqes (m2)
		Sipërfaqja m2	Niveli i taksës l/m2	Të ardhura	Sipërfaqja m2	Niveli i taksës l/m2	Të ardhura	Sipërfaqja m2	Niveli i taksës l/m2	Të ardhura		
a)	Ndërtuar para vitit 1993	1,291,080	9	11,620	90,000	5	450	927,555	5	4,638	16,708	2,308,635
b)	Ndërtuar gjatë dhe pas vitit 1993	553,320	9	4,980	210,000	5	1,050	397,523	5	1,988	8,017	1,160,843
c)	Ndërtesa të pashitura, por të hipotekuara si ndërtesa banimi	2,500	12	30	500	12	6	-	-	-	36	3,000
d)	Ndërtesa të dyta banimi	4,000	18	72	2,000	18	36	-	18	-	108	6,000
Totali		1,850,900		19,702	302,500		1,542	1,325,078		6,625	24,869	3,478,478
Ne % ndaj totali		67%		78%	9%		6%	24%		15%	100%	100%

Detyrimi për ndërtesën e banimit për të gjithë familjarët parashikohet të shlyhet në bazë mujore së bashku me faturën e shërbimit të furnizimit me ujë të Ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime Sh.A. Shkodër, në cilësinë e agentit tatimor. Për shërbimin, agjenti do të mbajë përkatësisht 2% të shumës së arkëtuar, dhe do të kalojë çdo muaj në llogari të bashkisë Shkodër pjesën prej 98% të saj.

Te ardhurat nga taksa e ndërtesave të banimit



Grafiku 18 Të ardhurat nga taksa e banesave sipas vitit të ndërtimit

Persa i përket peshës së të ardhurave nga kjo taksë, është bashkia Shkodër që do të përballojë rreth 67% të totalit të të ardhurave, ndërsa nëse i referohemi kategorisë së banesave, pjesa më e madhe e të ardhurave nga taksa mbi ndërtesat e banimit vjen nga banesat e ndërtuara para vitit 1993.

Të ardhura nga Taksa e ndërtesës për biznese


Kjo taksë administrohet nga Bashkia Shkodër. Baza e taksës është sipas rastit sipërfaqja e ndërtimit në metër katror e ndërtesës ose e pjesës së saj, mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për çdo kat.

Duke u krahasuar me referencën ligjore, taksa për ndërtesat ka një lehtësim që shkon deri në maksimumin e lejuar prej 30% për gjitha llojet e bizneseve si në zonat urbane, ashtu edhe në zonat rurale.

Më poshtë paraqitet tabela e të ardhurave nga taksa mbi ndërtesat e tjera, për qëllime biznesi, insitucione, etj., sipas grupeve të njësive administrative:

TE ARDHURAT NGA TAKSA MBI NDERTESAT E TJERA /BIZNESI

1.2 .1. 2	Kategorite e Ndertesave të tjera/biznesi	NjA Shkodër			NjA Velipojë			NjA të tjera			Totali (000/lek ë)	Totali I Siperfaq es (m2)
		Sipërfaq ja m2	Taksa lekë/ m2	Të ardhur a	Sipërfaqj a m2	Taksa lekë/ m2	Të ardhur a	Sipërfaq ja m2	Taks a lekë /m2	Të ardhu ra		
a)	Për tregti dhe shërbime.	151,400	270	40,878	96,000	120	11,520	39,020	120	4,682	57,080	286,420
b)	Per OJF, aktivitet artizanat, etj.	8,600	54	464	-	24	-	-	24	-	464	8,600
c)	Ndërtesa që përdoren për veprimtari prodhuese.	102,200	105	10,731	24,000	53	1,272	9,990	53	530	12,533	136,190
d)	Ndërtesa të pashitura, por të hipotekuara si ndërtesë biznesi.	-	210	-	-	105	-	-	105	-	-	-
Totali		262,200		52,073	120,000		12,792	49,010		5,212	70,077	431,210
Ne % ndaj totali		61%		74%	28%		18%	11%		8%	100%	100%



Grafiku 19 Të ardhurat nga ndërtesat e bizneseve, sipas llojit të aktivitetit

Planifikimi i të ardhurave është bërë mbi bazën e sipërfaqes aktuale të bizneseve në juridiksionin e bashkisë, si dhe duke iu referuar tendencës në rritje të kapacitetit të realizimit të të ardhurave ndër vite. Të ardhurat nga taksa për ndërtesat e banimit për vitin 2017 parashikohen në vlerën 70,077 mijë Lekë, për vitin 2018 me vlerë 72,179 mijë Lekë e për vitin 2019 me vlerë 74,344 mijë lekë, me një rritje prej 3% në vit.

Ne planifikimin e kësaj takse është parashikuar gjithashtu një shtrirje e mëtejshme e bazës taksapaguese falë politikave fiskale lehtësuese të ndërmarra, rivlerësimit të gjendjes faktike, përmirësimit të shërbimit dhe marrëdhënies me taksapaguesin, si dhe bashkëpunimit të pritshëm me institucione si ZRRPP, ALUIZNI etj

b) Të ardhura nga Taksa mbi tokën bujqësore

Kjo taksë administrohet nga Bashkia Shkodër. Baza e taksës është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi ose në përdorim të taksapaguesit.

Duke u krahasuar me referencën ligjore, taksa e çdo kategorie e tokës bujqësore ka një lehtësim që shkon në maksimumin e lejuar ligjor prej 30%.


Më poshtë paraqitet tabela e të ardhurave nga taksa mbi tokën bujqësore, sipas kategorive të tokës dhe njësive administrative:

TE ARDHURAT NGA TAKSA MBI TOKEN BUJQESORE

I.2.2	Kategorit e e tokës bujqësore	NjA Shkodër			NjA Velipojë			NjA të tjera			Totali (000/lekë)	Totali I Siperfaqes (m2)
		Sipërfaqja m2	Niveli i taksës lekë/m2	Të ardhura 000/lekë	Sipërfaqja m2	Niveli i taksës lekë/m2	Të ardhura 000/lekë	Sipërfaqja m2	Niveli i taksës lekë/m2	Të ardhura 000/lekë		
	I	-	2,940	-	-	2,940	-	600	2,940	1,764	1,764	600
	II	-	2,450	-	-	2,450	-	-	2,450	-	-	-
	III	-	1,960	-	350	1,960	686	5,557	1,960	10,892	11,578	5,907
	IV	-	1,610	-	290	1,610	467	2,700	1,610	4,347	4,814	2,990
	V	-	1,330	-	260	1,330	346	1,358	1,330	1,806	2,152	1,618
	VI	-	1,120	-	-	1,120	-	720	1,120	806	806	720
	VII – X	-	980	-	-	980	-	390	980	382	382	390
	Totali	-	-	-	900	-	1,499	11,325	-	19,997	21,496	12,225
	Ne % ndaj totali	0%	0%	7%	7%	93%	93%	100%	100%	100%	100%	100%

Planifikimi i të ardhurave bazohet mbikapacitetin aktual fiskal të njësive administrative, mbi parashikimin për zgjerimin e bazës së taksapaguesve nga grupet e punës nëpërmjet saktësimit të sipërfaqeve reale dhe kategorizimit të saktë dhe aktual të tokës bujqësore, si dhe duke iu referuar tendencës në rritje të kapacitetit të realizimit të të ardhurave ndër vite. Të ardhurat nga taksa e tokës bujqësore për vitin 2017 parashikohen në vlerën 21,496 mijë Lekë, për vitin 2018 me vlerë 21,711 mijë Lekë e për vitin 2019 me vlerë 21,928 mijë lekë, me një rritje prej 1% në vit.

Të ardhurat nga taksa mbi tokën bujqësore, sipas kategorive



Grafiku 20 Të ardhurat nga taksa e tokës bujqësore, sipas kategorisë së bonitetit të tokës

Referuar kategorive të tokës, pjesa me e madhe e të ardhurave nga taksa mbi tokën bujqësore vjen nga tokat bujqësore të kategorisë së III dhe të kategorisë së IV (rreth 76%).

c) Të ardhura nga Taksa mbi truallin

Me "Truall" kuptohet një sipërfaqe toke, jo tokë bujqësore, që ndodhet brenda vijës kufizuese të ndërtimit, e përcaktuar nëpërmjet dokumenteve ligjore të planifikimit, të miratuar për të ndërtuar mbi të. Baza e taksës është sipërfaqja në metër katror.

Për bizneset kjo taksë administrohet nga Bashkia Shkodër.

Për familjet detyrimi llogaritet dhe shlyhet në bazë mujore së bashku me faturën e shërbimit të furnizimit me ujë të Ndërmarrja Ujësjetllës Kanalizime Sh.A. Shkodër, në cilësinë e agentit tatimor.

Planifikimi i të ardhurave është bërë duke u bazuar në sipërfaqet aktuale të banesave dhe ndërtesave të tjera, dhe mbi parashikimin për zgjerimin e bazës së taksapaguesve nga grupet e punës nëpërmjet saktësisë së sipërfaqeve. Të ardhurat nga taksa e truallit për vitin 2017 parashikohen në vlerën 9,932 mijë Lekë, për vitin 2018 me vlerë 10,230 mijë Lekë e për vitin 2019 me vlerë 10,537 mijë lekë, me një rritje prej 3% në vit.


Pjesa me e madhe e sipërfaqes së taksueshme, rreth 53% e totalit është në Njësine Administrative Qendër. Nga të ardhurat në total të parashikuara nga taksa e truallit, 57% mbulohet nga Njësia Administrative Qendër, 23% nga Njësia Administrative Velipojë, dhe pjesa tjetër nga Njësitë e tjera. Referuar kategorive të truallit, pjesa më e madhe e të ardhurave të parashikuara nga kjo takse vjen nga trojet për qëllime biznesi (rreth 85%).

Më poshtë tabela e të ardhurave nga taksa mbi truallin, sipas kategorive të truallit dhe njësive administrative:

TE ARDHURAT NGA TAKSA MBI TRUALLIN

1. 2. 3	Kategorite e truallit	NJA Shkodër			NJA Velipojë			NJA të tjera			Total i (000/lekë)	Totali i Siperfaqes (m2)
		Sipërfaqja m2	Niveli i taksës lekë/m2	Të ardhura 000/lekë	Sipërfaqja m2	Niveli i taksës lekë/m2	Të ardhura 000/lekë	Sipërfaqja m2	Niveli i taksës lekë/m2	Të ardhura 000/lekë		
a)	Për qëllime banimi nga individët	1,850,900	0.42	777	302,500	0.42	127	1,372,837	0.42	577	1,481	3,526,237
b)	Për qëllime biznesi	270,700	18	4,875	120,000	18	2,160	78,680	18	1,416	8,451	469,380
	Totali	2,121,600		5,652	422,500		2,287	1,451,517		1,993	9,932	3,995,617
	Ne % ndaj totali	53%		57%	11%		23%	36%		20%	100%	100%

Te ardhurat nga taksa mbi truallin sipas kategorive



Grafiku 21 Të ardhurat nga taksa e truallit, sipas kategorizimit ligjor

Të ardhura nga Taksa e fjetjes në hotel

Kjo taksë administrohet nga Bashkia Shkodër.

Me "Hotel" kuptohet çdo subjekt tregtar që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim.

Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel për person, dhe përcaktohet me ligj.

Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet hoteli. Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes, dhe mbi të vlera e taksës.

Zonat	Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel në /000 Lekë		
	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019
Njësa Qendër	1,500	1,515	1,530
Velipojë	9,400	9,494	9,589
Rrethina	14	14	14
Totali	10,914	11,023	11,113

Planifikimi i të ardhurave është bërë duke parashikuar kapacitetet, numrin e njësive dhe periudhat e shfrytëzimit.

Të ardhura nga Taksa e ndikimit në infrastrukturë

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja administrohet nga Bashkia Shkodër.

Bazuar në ligjin 9632, taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja përcaktohet në kufijtë 4-8% e çmimit të shitjes për ndërtime për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e

ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik.

Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut sipas përcaktimeve të udhëzimit të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave”, që miratohet çdo vit.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndryshme nga ato të përmendura më lart është 3 % të vlerës së investimit që kërkohet të kryhet.

Bazuar në Ligjin Nr. 9482 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, taksa për ndërtesat në proces legalizimi llogaritet 0,5% e vlerës së investimit.

Planit për taksën e ndikimit në infrastrukturë bazohet mbi parashikimin e lejeve për ndërtime të reja dhe shlyerjen e detyrimeve për objektet në proces legalizimi .

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet në proces legalizimi administrohet nga Bashkia Shkodër.

Vjelja e kësaj takse paraqet vështirësi për bashkinë Shkodër, për arsye se subjektet dhe familjarët pasi kryejnë procedurat e legalizimit pranë ALUIZNI-it, arrijnë të kryejnë regjistrimin e pronës pa shlyer detyrimin përkatës. Realizimi i ardhurave nga kjo taksë lidhet dhe bazohet në zbatimin e masave shtrënguese, bllokimin e shërbimit të debitorëve nga bashkia Shkodër, si dhe në mbështetjen nga ZRRPP-ja.

Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë

Taksa e ndikimit në infrastrukturë	Viti 2017 /000 lekë	Viti 2018 /000 lekë	Viti 2019 /000 lekë
Taksa për ndërtimet e reja (përveç sektorit e turizmit, industrisë apo publik)	52.000	52.520	53.045
Taksa për ndërtimet e reja në sektorin e turizmit, industrisë apo publik	13.000	13.130	13.261
Taksa për ndërtimet të cilat janë në proces legalizimi	59.000	59.590	60.186
Totali	124,000	125,240	126,492

Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

Kjo taksë administrohet nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Taksa me nivelet sipas Ligjit Nr.9632 paguhet para kryerjes së regjistrimit, nga personi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, dhe vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të cilat, në rolin e agjentit tatimor përfitojnë 3% të shumës së arkëtuar, ndërsa diferencën e derdhin për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë Shkodër, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

Planifikimi bëhet nga agjenti tatimor si dhe bazuar në eksperiencën e viteve të kaluara rereferuar numrit të procedurave të tjetërsimit të pronës të kryera nga vetë ato.

**Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës
së pronësisë për pasuritë e paluajtshme**

	Viti 2017 /000 lekë	Viti 2018 /000 lekë	Viti 2019 /000 lekë
Bashkia Shkodër	6,500	6,760	7,030

Të ardhura nga Taksa e regjistrimit të mjeteve të përdorura

Bazuar në ligjin 9975 dt. 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare” të ndryshuar përcaktohet administrimi i taksës kombëtare të regjistrimit të mjeteve të përdorura, ku pas arkëtimit nga institucione shtetërore në rolin e agjentëve tatimorë, një pjesë e këtyre të ardhurave transferohen në buxhetin e njësisë të qeverisjes vendore sipas përkatësisë nga burojnë.

Referuar pikës 3, të Nenit 4 të Ligjit 9975, Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor në rolin e agjentit tatimor, arkëton detyrimin nga pronari i mjetit për vlerën e taksës për automjetin, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara, 18% e të ardhurave nga kjo taksë kalon për llogari të Bashkinë Shkodër.

Planifikimi bëhet nga agjenti tatimor referuar numrit të automjeteve dhe bazuar në eksperiencën e viteve të kaluara rereferuar të dhënave për nivelet e arkëtimeve.

Të ardhura nga taksa e regjistrimit të mjeteve të përdorura

	Viti 2017 /000 lekë	Viti 2018 /000 lekë	Viti 2019 /000 lekë
Bashkia Shkodër	51,000	52,530	54,106

Të ardhura nga Taksa e Rentës minerare

Bazuar në nenin 4 i ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 “Për Taksat Kombëtare” i ndryshuar, baza e taksës së rentës minerare llogaritet mbi burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka çdo person fizik apo juridik, në çastin kur ai shet produktin. Personi fizik apo juridik, që është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka. Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare. Degët e doganave në rrethe ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit, (5%) e të ardhurave të realizuara nga kjo taksë i kalon përkatësisht Bashkisë Shkodër në llogarinë e degës së thesarit.

Planifikimi i të ardhurave i referohet realizimit të të ardhurave ndër vite. Të ardhurat nga taksa e rentës minerare për vitin 2017 parashikohen në vlerën 60 mijë Lekë, për vitin 2018 me vlerë 61 mijë Lekë e për vitin 2019 me vlerë 62 mijë lekë, me një rritje prej 2% në vit

Të ardhura nga Taksa e Tabelës

Bazuar në Ligjin Nr. 9632, dt.30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, taksa e tabelës aplikohet për tre lloje tabelash, të përcaktuara sipas qëllimit të përdorimit dhe mënyrës së vendosjes së tyre:


Tabela për qëllime identifikimi, të cilat nëse janë të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi. Tabelat me sipërfaqe më të vogël se 2 m² nuk taksohen.

Tabela për qëllime reklamimi, ku përfshihen tabelat që nuk janë brenda territorit të biznesit ose nuk janë të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës, dhe që mund të jenë të thjeshta ose elektronike.

Tabela për qëllime ekspozimi, ku përfshihen tabelat me karakter të përkohshëm, për ekspozimeve të ndryshme të hapura, panairë, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.

Të ardhura nga taksa e tabelës

Llojet e tabelave	Viti 2017 /000 lekë	Viti 2018 /000 lekë	Viti 2019 /000 lekë
Tabelë identifikimi, mbi 2 metra katror	5.048	5.147	5.250
Tabela identifikimi jashtë territorit	6	6	6
Tabelë reklamimi, e thjeshtë	10.419	10.626	10.839
Tabelë reklamimi, elektronike	936	955	974
Ekspozimeve , stenda banderola, etj	250	255	260
TOTAL	16.656	16.989	17.329



Grafiku 22 Të ardhurat nga taksa e tabelës, sipas ndarjes ligjore

C.2 të ardhurat nga Tarifat Vendore

Referuar ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 35/5, bashkitë krijojnë të ardhura nga tarifat vendore për: shërbimet publike që ato ofrojnë; të drejtën e përdorimit të pronave publike vendore; dhënien e licencave, të lejeve, autorizimeve dhe për lëshimin e dokumenteve të tjera, për të cilat ato kanë autoritet të plotë, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe me ligj. Gjithashtu Bashkitë mund të krijojnë të ardhura nga veprimtaritë e tyre kulturore, sportive, dhe të tjera, të përcaktuara me ligj.

Bashkitë vendosin vetë për nivelin, mënyrën e mbledhjes dhe të administrimit të tarifave vendore, në përputhje me politikat dhe parimet e përgjithshme kombëtare të përcaktuara në ligjet në fuqi. Paketa fiskale e Bashkisë Shkodër e hartuar dhe e ndryshuar me përfshirjen e përfaqësuesve të komunitetit dhe të biznesit, pasqyron disa politika të rëndësishme lehtësuese, apo ulje të niveleve nga ajo e llogaritur referuar koston së shërbimit të ofruar. Disa prej tyre janë:

- Tarifa zero për shërbimin e ndriçimit publik dhe gjelbërimit për zonat rurale
- Tarifa zero për familjet me ndihmë ekonomike.
- Tarifa të reduktuara 50% sipas kriterëve për pensionistë, invalidë, etj.
- Tarifa 0 (zero) për Fermerët që janë regjistruar me NIPT nga Drejtoria Tatimore
- Tarifa të ulëta për ambulantë

Tabela e mëposhtme pasqyron të ardhurat nga tarifat për vitet 2017-2019, sipas llojit të shërbimeve që Bashkia do të ofrojë për qytetaret, bizneset apo institucionet:


në /000 lekë

LLOJET E TË ARDHURAVE	Plani 2017	Plani 2018	Plani 2019
TË ARDHURAT NGA BURIMET E VETA GJITHSEJ	616.046	622.746	633.465
Të ardhurat nga Tarifat vendore	254.341	257.654	261.012
Te ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave	135.020	136.665	138.331
Të ardhura nga tarifë pastrimi nga familjet	58.860	59.743	60.639
Të ardhura nga tarifë pastrimi nga institucione	165	167	169
Të ardhura nga tarifë pastrimi nga biznesi	75.995	76.755	77.523
Të ardhura nga tarifa për ndriçimin publik	28.344	28.628	28.914
Të ardhura nga tarifë për ndriçimin publik nga familje	17.076	17.247	17.419
Te ardhura nga tarifë ndricimi nga institucione	50	51	52
Të ardhura nga tarifë ndricimi nga biznesi	11.218	11.330	11.443
Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin	19.995	20.195	20.397
Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin nga familjet	8.538	8.623	8.709
Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin nga institucionet	50	51	52
Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin nga biznesi	11.407	11.521	11.636
Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë	51.323	52.310	53.316
Nga tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit	10	10	10
Nga tarifa për vulosje veterinerë të bagëtive të therura	100	101	102
Nga Tarifat e liçensimit të veprimtarive të transportit	1.535	1.550	1.566
Nga tarifa parkimi për mjetet e liçensuara, dhe për vendparkime publike	3.739	3.814	3.890
Nga tarifë për dhënie liçensa për tregtimin e naftës bruto dhe	600	606	612
Nga tarifat në sektorin e pyjeve dhe kullotave.	200	202	204
Nga tarifat e shërbimeve që kryen struktura e MKZ	1.925	1.964	2.003
Nga tarifa për zënien e hapësirave publike	41.714	42.548	43.399
Nga linjat ajrore dhe nëntokësore (Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet)	1.500	1.515	1.530
Të ardhura nga tarifa të institucioneve të arsimit, kultures, sportit, etj	19.659	19.856	20.054

Për vitin 2017-2019 të ardhurat e parashikuara nga tarifat përbëjnë rreth 41% të të ardhurave nga burimet e veta vendore.

Pjesë e rëndësishme në këtë kategori të të ardhurave nga tarifat janë të ardhurat nga tarifat për ofrimin e shërbimeve publike, si pastrimi e largimi i mbetjeve (53%), gjelbërimi (8%), ndriçimi publik (11%), të cilat së bashku zënë 72% të totalit të të ardhurave nga tarifat vendore.

Gjithashtu një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave nga tarifat vendore parashikohet të zënë të ardhurat për shfrytësimin e hapësirave publike (16%).



Grafiku 23 Pesha sipas zërave e të ardhurave nga tarifat vendore

Kriteri bazë për vendosjen e një tarife për shërbimin publik është kostoja e tij, dhe paguhet nga familjet apo bizneset të cilët kontribuojnë dhe e përfitojnë këtë shërbim.

Ngarkesa e tarifimit është shpërndarë duke u bazuar:

- në vendndodhjen (zonë urbane apo zonës rurale),
- në llojin e aktivitetit (tregti, shërbim, prodhim, profesion i lirë, fermer, transport, ndërtim, karburant, institucion, ofj, etj)
- dhe në statusin e subjektit (familjar, biznes i madh, biznes i vogël, institucion shtetëror, ambulant etj).

Parashikimi i të ardhurave nga biznesi bëhet duke u bazuar në kapacitete, si dhe në shtrirjen e mëtejshme të bazës taksapaguese falë politikave fiskale lehtësuese, përmirësimit të shërbimit dhe marrëdhënies me taksapaguesin, fokusimit në zona me kapacitete të pashfrytëzuara, si dhe sensibilizimin dhe trajtimin e biznesit si partner në dhënien e shërbimeve për komunitetin.

Te ardhura nga tarifat e shërbimeve publike për pastrimin e largimin e mbetjeve, gjelbërimin dhe ndriçimin publik

Tarifat familjare për pastrim, ndriçim, gjelbërim për të gjithë taksapaguesit do të shlyhen në bazë mujore së bashku me faturën e shërbimit të furnizimit me ujë tek Ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime Sh.A. Shkodër, në cilësinë e agentit tatimor. Për shërbimin, agentin do të mbajë përkatësisht 2% të shumës së arkëtuar, dhe do të kalojë çdo muaj në llogari të bashkisë Shkodër pjesën prej 98% të saj.

	Të ardhura nga tarifa e pastrimit		në /000 lekë
	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019
Nj.A Qendër Familje	42,675	43,315	43,964
Nj.A. Velipojë Familje	3,000	3,045	3,091
Nj.A të tjera Familje	13,185	13,383	13,584
Nj.A Qendër Institucione	100	101	102
Nj.A. Velipojë Institucione	10	10	10
Nj.A të tjera Institucione	55	56	57
Nj.A Qendër Biznese	62,900	63,529	64,165
Nj.A. Velipojë Biznese	6,280	6,343	6,406
Nj.A të tjera Biznese	6,815	6,883	6,952
TOTAL	135,020	136,665	138,331

	Të ardhura nga tarifa e ndriçimit		në /000 lekë
	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019
Nj.A Qendër Familje	17,076	17,247	17,419
Nj.A. Velipojë Familje	-	-	-
Nj.A të tjera Familje	-	-	-
Nj.A Qendër Institucione	50	51	52
Nj.A. Velipojë Institucione	-	-	-
Nj.A të tjera Institucione	-	-	-
Nj.A Qendër Biznese	10,812	10,920	11,029
Nj.A. Velipojë Biznese	406	410	414
Nj.A të tjera Biznese	-	-	-
TOTAL	28,344	28,628	28,914

	Të ardhura nga tarifa e gjelbrimit		në /000 lekë
	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019
Nj.A Qendër Familje	8,538	8,623	8,709
Nj.A. Velipojë Familje	-	-	-
Nj.A të tjera Familje	-	-	-
Nj.A Qendër Institucione	50	51	52
Nj.A. Velipojë Institucione	-	-	-
Nj.A të tjera Institucione	-	-	-
Nj.A Qendër Biznese	10,992	11,102	11,213
Nj.A. Velipojë Biznese	415	419	423
Nj.A të tjera Biznese	-	-	-
TOTAL	19,995	20,195	20,397

Të ardhura të tjera të bashkisë

Të ardhura nga tarifa të drejtorisë të zhvillimit të territorit

Nga ky zë parashikohen rreth 10 mije lekë në vit nga tarifat që mbulojnë kostot administrative të drejtorisë së planifikimit dhe kontrollit të territorit për shërbimin që i ofron subjekteve.

